



**AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI**  
**AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST**  
**INFORMATION AND PRIVACY AGENCY**

## **Raporti Vjetor i Performancës**

*PRISHTINË 2026*

---

*\*Sqarim: Raporti nuk është aprovuar akoma nga Kuvendi i Republikës së Kosovës*



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI**  
**AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST**  
**INFORMATION AND PRIVACY AGENCY**



***RAPORTI VJETOR I PERFORMANCES***  
***PËR VITIN 2025***

***PRISHTINË***  
***Mars, 2026***



## Përmbajtja

1	Përmbledhje Ekzekutive.....	5
2	Korniza Ligjore .....	7
2.1	Baza Ekzistuese Ligjore që Rregullon Punën e Agjencisë.....	7
2.1.1	Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.....	7
2.1.2	Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.....	8
2.2	Përmirësimi i Bazës Ligjore në Periudhën Raportuese .....	8
3	Përshkrimi i Institucionit (Organizimi Institucional) .....	9
3.1	Misioni/Vizioni .....	9
3.1.1	Misioni.....	9
3.1.2	Vizioni .....	9
3.2	Kompetencat.....	10
4	Fushëveprimi i Agjencisë.....	11
4.1	Organizimi i Agjencisë.....	11
4.1.1	Struktura Organizative e Agjencisë për Informim dhe Privatësi.....	11
4.1.2	Organogrami i Agjencisë për Informim dhe Privatësi.....	11
4.2	Komisionerja e Agjencisë.....	12
4.2.1	Kompetencat dhe Funkcionalizimi .....	12
4.3	Ekzekutivi.....	13
4.3.1	Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë .....	13
4.3.2	Njësitë organizative të Agjencisë .....	13
4.4	Burimet Njerëzore .....	15
4.4.1	Numri i Zyrtarëve .....	15
4.4.2	Ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Agjencisë.....	16
4.5	Asetet.....	17
4.5.1	Asetet në Posedim të Institucionit .....	17
4.5.2	Planet për Asete të Reja.....	17
5	Aktivitetet e Agjencisë në vitin 2025 .....	18
5.1	Aktivitetet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale .....	18
5.1.1	Inspektimi dhe Kontrolli.....	18
5.1.2	Ankesat .....	20
5.1.3	Përgatitja e raporteve dhe nxjerrja e vendimeve.....	21
5.1.4	Trajnimet - Mbrojtja e të dhënave personale .....	22
5.1.5	Mbrojtja e të dhënave personale në diskursin publik dhe medial.....	24
5.2	Aktivitetet në fushën e Qasjes në Dokumente Publike.....	25
5.2.1	Shqyrtimi i Ankesave për Qasje në Dokumenteve Publike.....	25



5.2.2	Krahasimi i kategorisë së ankuesve.....	27
5.2.3	Institucionet dhe numri i ankesave të parashtruara në AIP gjatë periudhës 2021-2025	28
5.2.4	Vendimet ndaj ankesave për vitin 2025 .....	29
5.3	Monitorimi dhe raportimi .....	32
5.3.1	Monitorimi i ueb faqeve zyrtare të Institucioneve Publike .....	32
5.3.2	Kërkesat për qasje në dokumente publike ndaj institucioneve .....	34
5.4	Aktivitetet në fushën ligjore të Agjencisë .....	37
5.4.1	Legjislacioni .....	37
5.4.2	Këshillat ligjore .....	38
5.4.3	Përfaqësimi Gjyqësor .....	39
5.4.4	Vendimet për Autorizim të përdorimit të karakteristikave biometrike.....	39
5.4.5	Transferimi i të Dhënave Personale.....	40
5.5	Sfidat .....	40
6	Bashkëpunimi ndërinstitucional, regional dhe ndërkombëtar .....	42
6.1	Anëtarësimet Ndërkombëtare në 2025 .....	42
6.1.1	Organizimet e punëtorive/konferencave vendore 2025.....	43
6.2	Angazhimi ndërkombëtar dhe organizimi i aktiviteteve në Kosovë .....	43
6.3	Pjesëmarrja e AIP në grupe punuese jashtë vendit.....	44
6.4	Rekomandimet.....	48
7	Raporti Financiar .....	49
8	Raportimi rreth Adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.....	67



# 1 Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), si institucion i pavarur dhe i specializuar në zbatimin e politikave shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike në Republikën e Kosovës, paraqet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht Komisionin Parlamentar për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtje dhe prezanton realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara me Planin e Performancës për vitin 2025.

Raporti vjetor i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2025, prezanton të arriturat dhe sfidat e Agjencisë në zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit. Ky dokument reflekton punën dhe angazhimin e Agjencisë në trajtimin e ankesave, trajtimin e ankesave për qasje në informata për mbrojtjen e të dhënave, ofrimin e këshillave, forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin me institucionet publike dhe private.

Agjencia ka ushtruar fushë veprimtarinë e saj në mënyrë objektive dhe profesionale, në trajtimin e ankesave të adresuara, ofrimin e këshillave dhe opinioneve për institucionet publike, private, qytetarëve dhe grupe tjera të interesit. Përmes ekspertizës profesionale, Agjencia ka ofruar mbështetjeje për institucionet publike dhe private në hartimin e akteve nën-ligjore dhe rregullativës së brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe politikën e privatësisë.

Në përmbushjen e mandatit të saj ligjor për realizimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumentin publike, gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2025, Agjencia ka pranuar gjithsejtë njëmijë e tetëdhjetë e pesë (1,085) ankesa të adresuara nga institucionet publike dhe private, Organizatat Jo Qeveritare, Mediat, Qytetarët dhe nga grupe të tjera të interesit. Në realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, Agjencia gjatë vitit 2025 ka pranuar gjithsejtë nëntëqind e njëzet e shtatë (927) ankesa, dhe tetëdhjetë (80) të bartura nga viti paraprak. Nga ky numër, 832 ankesa kanë përfunduar me vendime administrative ndërsa 175 ankesa janë bartur për vitin 2026.

Në realizimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia gjatë vitit 2025 ka pranuar gjithsejtë njëqind e pesëdhjetë e tetë (158) ankesa, dhe dymbëdhjetë (12) të bartura nga viti paraprak. Nga ky numër, njëqind e tridhjetë e nëntë (139) ankesa kanë përfunduar me vendime administrative ndërsa nëntëmbëdhjetë (19) ankesa janë bartur për vitin 2026.

Në funksion të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit dhe garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve, gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka realizuar gjithsejtë 367 inspektime. Prej tyre, 226 inspektime janë realizuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa 141 inspektime janë realizuar sipas ankesave të adresuara në Agjenci.

Me qëllim të harmonizimit të kuadrit ligjor me standardet evropiane, Agjencia ka vazhduar veprimet për finalizimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Institucionet e Zbatimit të Ligjit, në përputhje me Direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (e njohur si Law Enforcement Directive – LED).

Në përmbushje të funksionit të saj ligjor, Agjencia ka ofruar gjithsejtë pesëdhjetë e tetë (58) këshilla ligjore, ku njëzet e nëntë (29) këshilla janë lëshuar për institucionet nga sektori publik,



shtatëmbëdhjetë (17) për institucionet nga sektori privat, dhe dymbëdhjetë (12) këshilla sipas kërkesës së qytetarëve si subjekte të të dhënave.

Aktivitetet e Agjencisë në vitin 2025, janë përqendruar në thellimin e bashkëpunimit me institucionet publike dhe private, organizatat joqeveritare dhe sektorin e mediave, duke promovuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike përmes trajnimeve, punëtorive dhe fushatave ndërgjegjëse me qëllim të promovimit, të të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike.

Në këtë kontekst, gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, janë realizuar mbi 80 aktivitete informuese dhe janë trajnuar mbi 800 pjesëmarrës nga sektori publik dhe privat, përfshirë zyrtarë publik, kontrollues dhe përfaqësues nga grupe tjera të interesit, sektori i shëndetësisë, sistemi bankar, qendrat sociale, organizatat joqeveritare, mediat dhe subjekte të tjera.

Përmes ekspertizës profesionale dhe me qëllim të mbështetjes së kontrolluesve dhe përpunuesve nga sektori publik dhe privat, në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe standardizimin e qasjes gjatë përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë, proporcionalitetit dhe transparencës, gjatë kësaj periudhe, Agjencia ka finalizuar dhe publikuar katër (4) Udhëzues për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Njëra ndër prioritetet e Agjencisë në vitin 2025, ka qenë e orientuar në informimin dhe ndërgjegjshmin, përkatësisht ofrimin e trajnimeve për institucionet lidhur me masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale. Në totalin e realizimit të planit për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve, për të siguruar zbatimin e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë vitit 2025, Agjencia ka ofruar programe të trajnimit për gjithsejtë 807 zyrtarë.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, Agjencia ka ndërmarrë hapa dhe veprime konkrete në funksionalizimin e procesit të digjitalizimit, duke lansuar projektin e CMS – Sistemi i Menaxhimit të Rasteve, projekt i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj palëve të ndryshme të interesit të cilët i adresohen Agjencisë, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve më të mira, transparente dhe më efikase për qytetarët. Realizimi i projektit të digjitalizimit, është në harmoni të plotë me procesin e zvogëlimit të barrës administrative, proces i cili është iniciuar dhe kryesohet nga Qeveria e Kosovës.

Implementimi i digjitalizimit nga ana e Agjencisë nëpërmjet projektit CMS, në veçanti do të mundësojë trajtimin përkatësisht shqyrtimin e ankesave nga fusha e mbrojtjes së të dhënave dhe qasjes në dokumente publike, duke ofruar transparencë, llogaridhënies dhe mundësi raportimi në kohë reale lidhur me veprimet që ndërmerren nga zyrtarët përgjegjës në kuadër të shqyrtimit të një ankese.

Në relacioni, me përmbushjen e misionit të transparencës dhe llogaridhënies, Agjencia gjatë vitit 2025, ka publikuar në platformat elektronike të informimit të gjitha dokumentet, informatat lidhur me fushëveprimin e saj në veçanti informatat për shpenzimin e parasë publike.



## 2 Korniza Ligjore

Agjencia për Informim dhe Privatësi, është institucion kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe në kuadër të mandatit të saj ligjor ka nxjerr aktet nënligjore të cilat derivojnë nga dy ligjet e lartpërmendura dhe ka të kompletuar në tërësi bazën ligjore.

Agjencia në vazhdimësi të avancimit të mëtejshëm të kornizës ligjore për sa i përket fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, në vitin 2025, ka iniciuar hartimin e Projektligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga Institucionet e zbatimit të Ligjit. Në kuadër të zhvillimit të procesit të hartimit të këtij projektligji, Agjencia e cila njëkohësisht e kryeson këtë proces, ka zhvilluar aktivitetet përkatëse, ku ndër të tjera ka organizuar dhe mbajtur takime të grupit punues, ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe konsultimeve publike si dhe ka bërë inkorporimin e komenteve të pranuar nga institucionet kompetente nga ky proces. Aktualisht, ky projektligj është në fazën përfundimtare, i cili pritet që në bashkëpunim me Zyrën Ligjore pranë Zyrës së Kryeministrit, i njëjti të procedohet për të siguruar vlerësimet përkatëse nga Ministritë përgjegjëse. Projektligji është pjesë e Programit Legjislativ për vitin 2026, dhe sapo të përfundojnë aktivitetet e lartcekura, i njëjti do të procedohet për shqyrtim dhe aprovim në Qeverinë e Kosovës.

Në kuadër të kompletimit të mëtejshëm të kornizës ligjore, me qëllim të thjeshtëzimit dhe lehtësimit të procesit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka aprovuar dhe publikuar gjithsejtë 3 (tre) udhëzues, për fushat specifike të ligjit, çka do të ndihmojë kontrolluesit përkatësisht zbatuesit në implementimin e procedurave dhe obligimeve përkatëse të cilat derivojnë nga ky ligj.

### 2.1 Baza Ekzistuese Ligjore që Rregullon Punën e Agjencisë

Agjencia si autoritet i pavarur funksionon duke zbatuar kornizën ligjore, si në vijim:

#### 2.1.1 Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

- Rregullore Nr. 01/2021 (AIP) për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Informim dhe Privatësi
- Rregullore Nr. 01/2022 (AIP) për Mënyrën e Ruajtjes dhe Shfrytëzimit të Materialit Arkivor dhe Protokollit së Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
- Rregullore nr. 02/ 2022 për Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Ankesave për Qasje në Dokumente Publike;
- Rregullore Nr. 03/2022 për Mënyrën e Kryerjes së Inspektimit dhe Kontrollit
- Rregullore Nr. 04/2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Rregullore Nr. 05/2022 mbi Masat e Sigurisë Gjatë Përpunimit të të Dhënave Personale;
- Rregullore Nr. 06/2022 mbi Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Autorizimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale;
- Rregullore Nr. 02/2023 për Përpunimin e të Dhënave të Cilat Merren nga Përdorimi i Dronëve;



- Rregullore Nr. 03/2023 për Përcaktimin e Tarifave për Njoftimet dhe Autorizimet që Lëshohen nga Agjencia për Informim dhe Privatësi;
- Rregullore Nr. 04/2023 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për lëshimin e certifikatës për përpunimin e të dhënave personale;
- Rregullore Nr. 01/2024 për procedurat, masat teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

### 2.1.2 Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike

- Rregullore Nr. 01-2025 për Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Ankesave për Qasje në Dokumente Publike
- Rregullore Nr. 01/2023 për Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës dhe Raportimit për Zbatim të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Krahas nxjerrjes së akteve juridike të lartpërmendura, Agjencia në kuadër të kornizës së saj ligjore, ka të aprovuar edhe Udhëzues përkatës sipas ligjeve të lartpërmendura, si në vijim:

- Udhëzues praktik për lehtësimin e ushtrimit të drejtës për qasje në dokumente publike;
- Udhëzues për përmbajtjen e faqeve të internetit të institucioneve publike;
- Udhëzues për parti politike gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore;
- Udhëzues për përdorimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë për kontrolluesit e të dhënave;
- Udhëzues për përpunimin e të dhënave personale për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë;
- Doracak për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Udhëzues për regjistrat e aktiviteteve të përpunimit të të dhënave personale;
- Udhëzues për përdorimin e karakteristikave biometrike;
- Udhëzues për zhvillimin e testit të dëmit dhe interesit publik.

## 2.2 Përmirësimi i Bazës Ligjore në Periudhën Raportuese

Agjencia për Informim dhe Privatësi, duke u bazuar në angazhimet e saja ligjore, në veçanti gjatë procesit të koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta me institucionet kompetente për zbatimin e ligjit, ka zhvilluar tutje procesin e hartimit të Projektligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga institucionet e zbatimit të ligjit. Gjatë këtij viti, janë zhvilluar aktivitete përkatëse drejt finalizimit të këtij projektligji, ku ndër të tjera janë mbajtur takime të grupit punues, si dhe takime të veçanta me ekspertët e angazhuar nga Zyra e Këshillit të Evropës. Ndërsa, në aspektin administrativ, janë zhvilluar procedurat përkatëse, ku rëndësi të veçanta ka zhvillimi i procesit të konsultimeve paraprake dhe konsultimeve publike me institucionet kompetente, si dhe konsultimi publik nëpërmjet platformës elektronike të konsultimeve e cila administrohet nga Zyra e Kryeministrit.

Ndërsa, në kuadër të rregullimit të brendshëm ligjor, Agjencia për Informim dhe Privatësi pas shqyrtimit dhe analizimit të procedurave të brendshme të shqyrtimit të ankesave në fushën e qasjes në dokumente publike, ka iniciuar hartimin e rregullores së re për procedurën e brendshme të shqyrtimit të ankesave për qasje në dokumente publike. Kjo rregullore është



përgatitur nga Agjencia, ku në kuadër të hartimit të saj, janë konsultuar me theks të veçantë Organizatat e Shoqërisë Civile, të cilave u është dërguar paraprakisht drafti i rregullores me qëllim të ofrimit të komenteve apo sugjerimeve të tyre, e gjithë kjo në kuptim të transparencës dhe llogaridhënies institucionale në raport me këto organizata.

Përveç akteve juridike të lartpërmendura, Agjencia për Informim dhe Privatësi gjatë vitit 2025, me qëllim të lehtësimit të zbatimit të obligimeve ligjore nga institucionet e sektorit publik dhe privat, ka nxjerrë katër (4) udhëzues sektorial nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale, si në vijim:

- Udhëzues lidhur me privatësinë në internet
- Udhëzues për përpunimin e ligjshëm të të dhënave
- Udhëzues për vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave
- Udhëzues për sektorin shëndetësor.

### **3 Përshkrimi i Institucionit (Organizimi Institucional)**

#### **3.1 Misioni/Vizioni**

##### **3.1.1 Misioni**

Agjencia është institucion shtetëror i pavarur, i themeluar në bazë të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe garantimin e qasjes në dokumente publike, bazuar në Ligjin Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

##### **3.1.2 Vizioni**

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj, Agjencia synon të realizojë këto objektiva:

- Ndërgjegjësimin për të drejtën e qasjes në dokumente publike dhe mbrojtjes së të dhënave personale, përmes fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese për qytetarët, institucionet publike dhe ato private;
- Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave përmes inspektimeve dhe kontrolleve, si dhe kontrollin e ofrimit të qasjeve në dokumente publike nga institucionet publike;
- Thellimin e bashkëpunimit me organet dhe institucionet tjera, si dhe me mekanizmat dhe institucionet ndërkombëtare, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike;
- Ngritjen profesionale të personelit të AIP-së;
- Funkcionalizimin e plotë të strukturës organizative;



- Bashkëpunimin rajonal dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me karakter rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike.

### 3.2 Kompetencat

Agjencia bazuar në autorizimet ligjore të dhëna nga Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka këto kompetenca:

- Jep këshilla për institucionet publike dhe private për të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse;
- Informon publikun për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave;
- Promovon dhe përkrahë të drejtat themelore për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Vendosë lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave;
- Këshillon parlamentin, qeverinë, institucionet dhe organet e tjera të brendshme mbi masat legjislative dhe administrative në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë për sa i takon përpunimit të të dhënave;
- Kryen inspektime lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe shqipton gjoba ndaj kontrolluesve publikë dhe privatë, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-082;
- Sipas rastit, kryen një rishikim periodik të certifikimeve të dhëna në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-082 dhe mund të tërheqë certifikimin, në rast se nuk plotësohen kriteret e certifikimit;
- Me vetiniciativë ose me kërkesë, jep opinione për institucionet publike dhe organet tjera, si dhe publikon për çdo çështje lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale;
- Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes apo mos përgjigjes së institucionit publik, shqyrton ankesat e qytetarëve të ushtruara në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje.
- Është kompetente për shqiptimin e gjobave ndaj institucioneve publike dhe zyrtarëve përgjegjës, sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-081;
- Shqyrton ankesat e qytetarëve, në rastet kur e drejta për qasje në dokumente publike nuk jetësohet tek institucionet publike, si instancë e parë;
- Zhvillon trajnimet për rrjetin e zyrtarëve përgjegjës për qasje në dokumente publike të të gjitha institucioneve publike;
- Lanson fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për qytetarët dhe për institucionet publike lidhur me të drejtën për qasje në dokumente publike;
- Monitoron faqet zyrtare të institucioneve publike për t'u siguruar që po bëhet publikimi me vetiniciativë i dokumenteve publike;



## 4 Fushëveprimi i Agjencisë

### 4.1 Organizimi i Agjencisë

#### 4.1.1 Struktura Organizative e Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Agjencia për Informim dhe Privatësi në kuadër të strukturës së saj funksionale, është e organizuar, si në vijim:

##### **ZYRA E KOMISIONERIT**

##### **ZYRA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM**

- Menaxheri i Burimeve Njerëzore;
- Zyrtari Certifikues.

##### **DEPARTAMENTI PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE**

- Divizioni për Monitorim dhe Raportim;
- Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave për Qasje në Dokumente Publike.

##### **DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

- Divizioni i Inspektimit dhe Kontrollit;
- Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

##### **DEPARTAMENTI LIGJOR**


- Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit;
- Divizioni për Certifikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

##### **DIVIZIONI PËR SHËRBIME TË PËRGJITHSHME**

##### **DIVIZIONI PËR MENAXHIM FINANCIAR**

#### 4.1.2 Organogrami i Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Organizimi i Agjencisë, është i përcaktuar me Rregulloren 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, në ushtrimin e mandatit ligjor të përcaktuar me nenin 58 të Ligjit 06/L-082 për Mbrojtje e të Dhënave Personale dhe Ligjin 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.



Organogrami i Agjencisë për Informim dhe Privatësi bazuar në “Rregullore Nr. 01/2021 (AIP) për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Informim dhe Privatësi”

## 4.2 Komisionerja e Agjencisë

Agjencia për Informim dhe Privatësi udhëhiqet nga Komisioneri, i cili në bazë të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përfaqëson agjencinë, organizon dhe koordinon punën e saj.

Komisionerja zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar deri më 17 qershor 2026, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat shtesë. Procedura për zgjedhje fillon me shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e Komisionerit, i cili publikohet në mediumet e shkruara dhe elektronike.

Në kuadër të ushtrimit të mandatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, në kuptim të sigurimit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Komisioneri ndër të tjera është kompetent për nxjerrjen e akteve nënligjore me qëllim të zbatimit të këtyre dy ligjeve.

Komisioneri si titullar i agjencisë zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat shtesë.

### 4.2.1 Kompetencat dhe Funkcionalizimi

Komisioneri është organ i pavarur, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, në kuadër të Agjencisë, i cili është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.



Agjencia udhëhiqet nga Komisioneri, i cili përfaqëson Agjencinë, organizon dhe koordinon punën e saj.

## 4.3 Ekzekutivi

### 4.3.1 Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë

Drejtorja e Përgjithshme kryen të gjitha detyrat e zyrtarit kryesor administrativ, në pajtim me legjislacionin përkatës, mbështet dhe ofron këshilla të nivelit të lartë për titullarin e institucionit në përcaktimin e politikave, organizon punën dhe përcakton detyrat sipas njësive kryesore administrative. Siguron implementimin e një strukture të kontrollit të brendshëm financiar në organizatën buxhetore, përmirësimin e standardeve në të gjitha shërbimet e ofruara nga institucioni, përgatit analizat e nevojshme për nevojat buxhetore dhe ofron mbështetjen efikase administrative, marrjen e vendimeve sipas legjislacionit përkatës për mbarëvajtjen e punës së institucionit.

### 4.3.2 Njësitë organizative të Agjencisë

Agjencia për Informim dhe Privatësi, në kuadër të strukturës së saj të brendshme organizative, përbëhet nga Departamentet përkatësisht Divizionet, si në vijim:

- Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Departamenti për Qasje në Dokumente Publike
- Departamenti Ligjor
- Divizioni për Menaxhim Financiar
- Divizioni për Shërbime të Përgjithshme

#### 4.3.2.1 Departamenti për Qasje në Dokumente Publike

Departamenti për qasje në dokumente publike drejton, menaxhon dhe koordinon zhvillimin e politikave për të garantuar të drejtën e qasjes në dokumente publike përmes mbikëqyrjes së punës së institucioneve publike gjatë zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Qasje në Dokumente Publike janë:

- Pranon dhe shqyrton ankesat për qasje në dokumente publike;
- Zhvillon seanca dëgjimore me palët në kuadër të shqyrtimit të ankesave;
- Monitoron përmbajtjen e ueb faqeve zyrtare të transparencës së institucioneve publike;

Në kuadër të Departamentit për Qasje në Dokumente publike funksionojnë dy divizione:

- Divizioni për Monitorim dhe Raportim;
- Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave për Qasje në Dokumente Publike.

#### 4.3.2.2 Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të përgjegjës për menaxhimin, koordinimin dhe zhvillimin e politikave për të garantuar të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale



përmes mbikëqyrjes së institucioneve publike dhe private gjatë zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë:

- Pranon dhe shqyrton ankesat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Zhvillon, planifikon dhe ndërmer veprime inspektuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Mbikëqyrë përshtatshmërinë e procedurave dhe masave të marra për sigurinë e të dhënave personale në pajtim me ligjin;

Në kuadër të Departamentit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale funksionojnë dy divizione:

- Divizioni për Inspektim dhe Kontroll;
- Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

#### 4.3.2.3 Departamenti Ligjor

Departamenti Ligjor si njësi përkatëse në kuadër të Agjencisë, është përgjegjës për koordinimin e procesit të hartimit të legjislacionit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar nga fushëveprimi i Agjencisë, duke siguruar respektimin e teknikave dhe standardeve për hartimin e legjislacionit, ofron mbështetje profesionale, këshilla ligjore dhe rekomandime për strukturat tjera në kuadër të Agjencisë.

Përveç detyrave dhe përgjegjësi të përgjithshme të lartpërmendura, Departamenti Ligjor në mënyrë të veçantë merret me:

- Hartimin e legjislacionit nga fushëveprimi i Agjencisë;
- Siguron harmonizimin me legjislacionin vendor dhe atë të BE-së;
- Siguron mbështetje ligjore në hartimin e akteve të ndryshme juridike;
- Përgatit këshilla dhe opinione ligjore për njësitë tjera brenda AIP-së si dhe për institucionet tjera publike dhe private;
- Përgatitë dhe harton vendime autorizuese për transferimin ndërkombëtar të të dhënave për vendet dhe organizatat ndërkombëtare dhe vendime autorizuese lejuese për përdorimin e të dhënave biometrike;
- Përfaqëson Agjencinë në procedura gjyqësore në të cilat është palë AIP; etj.

Në kuadër të Departamentit Ligjor funksionojnë dy divizione:

- Divizioni për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit; dhe
- Divizioni për certifikim dhe bashkëpunim ndërkombëtarë.

#### 4.3.2.4 Divizioni për Menaxhim Financiar

Divizioni për Menaxhim Financiar planifikon, zbaton kontabilitetin dhe përgatit raporte financiare.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Menaxhim Financiar janë:

- Harton dhe monitoron përgatitjen e buxhetit vjetor të agjencisë, duke mbajtur kontabilitetin dhe bashkëveprimin me Departamentin e Thesarit në përputhje me ligjin;
- Përgatit dhe harton KASH-in, në bashkëpunim me njësitë kërkuese, dhe unifikon kërkesat e KASH-it për të gjitha strukturat e agjencisë;



- Menaxhon rezervat e parasë dhe siguron se kontrolli i brendshëm financiar është bazuar në parimet e përcaktuara me ligj dhe akte tjera;
- Siguron që organizata buxhetore i ka respektuar të gjitha qarkoret buxhetore dhe udhëzimet administrative lidhur me hartimin dhe ekzekutimin e buxhetit;
- Bën evidentimin e të gjitha të hyrave dhe raportimin e gjendjes së të hyrave;

#### 4.3.2.5 Divizioni për Shërbime të Përgjithshme

Divizioni për Menaxhim të Përgjithshëm planifikon dhe koordinon shërbimet administrative, logjistike dhe të TI-së për të gjitha organet në kuadër të Agjencisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Menaxhim të Përgjithshëm janë:

- Menaxhon dhe mirëmban pasurinë dhe materialin tjetër në depo, si dhe ofron mbështetje administrative dhe logjistike;
- Siguron zbatimin e procedurave për menaxhim me të gjitha automjetet që disponon Agjencia, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Identifikon, planifikon dhe parashton kërkesa në institucionin përkatës për teknologji informative për mbajtjen aktive të të gjitha programeve të teknologjisë informative në agjenci;
- Siguron organizimin e punëve administrative të arkivit fizik dhe elektronik të dokumenteve të brendshme të agjencisë.

### 4.4 Burimet Njerëzore

Burimet Njerëzore, në pajtim me nenin 16 paragrafit të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndër të tjera janë përgjegjëse për:

- Ofrimin e mbështetjes për nëpunësin më të lartë administrativ dhe/apo për titullarin e institucionit në fushën e burimeve njerëzore;
- Përgatitjen e planit vjetor të personelit, në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit;
- Ofrimin e ndihmës për njësitë përkatëse rreth përgatitjes së përshkrimeve, klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës;
- Identifikimin dhe vlerësimin, në koordinim me udhëheqësin e njësisë në mënyrë periodike, nevojave për trajnim të nëpunësive civil të institucionit, për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve për zhvillimit profesional;
- Menaxhimin e proceseve të ndërlidhura me emërimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, transferimit, suspendimit, pensionimit dhe çdo proces tjetër që ndërlidhet me punësimin e zyrtarëve publik;
- Mbështetjen në procedurën për vlerësimin e performancës, rekomandimeve për transferimin e nëpunësit civil, si dhe menaxhimin të paraqitjes në punë të zyrtarëve publik;
- Administrimin e planeve dhe dosjeve individuale përmes SIMBNj-së;

#### 4.4.1 Numri i Zyrtarëve

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2025, Rregullores nr.01/2021 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së AIP, numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara ka



qenë 34, nga i cili, një (1) pozitë i përket Komisionerit të Agjencisë, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës si dhe stafi mbështetës – një vozitës, ndërsa 32 pozita pune janë nëpunës civil të karrierës.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka rekrutuar 2 nëpunës, ndërsa në zbatim të Planit të Personelit për vitin 2025 ka paraparë të plotësohen vendet vakante edhe për 1 pozita pune.

Pas publikimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KO222/24 dhe KO224/24, në Gazetën Zyrtare është publikuar Ligji Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, është ndryshuar dhe plotësuar disa dispozita të ligjit bazik dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare përkatësisht më 17.06.2025.

Në këtë kuadër, NJMBNJ, ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe ka hartuar akt-emërimet për nivelin e mesëm dhe të ulët drejtues të cilat janë nënshkruar nga të njëjtit.

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2025		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Zyra e Komisioneres	2	3		3		2	
Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm	4	4		4		4	
Departamenti për MDHP	7	6		6		5	
Departamenti për QDP	7	9		9		5	
Departamenti Ligjor	7	6		5		4	
Divizioni për MF	4	2		2		2	
Divizioni për Shërbime të Përgjithshme	3	3		3		2	
<b>Gjithsej</b>	<b>34</b>	<b>33</b>		<b>32</b>		<b>24</b>	

#### 4.4.2 Ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Agjencisë

Në kuadër të Programit të Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX), pesë (5) zyrtarë nga Departamenti Ligjor dhe ai i Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, në Maj të 2025, realizuan një vizitë tre ditore studimore në Autoritetin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Sllovenisë. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Me synim përforcimin e kapaciteteve institucionale dhe afrimin me standardet e Bashkimit Evropian, gjatë vizitës u zhvilluan:

Diskutime mbi mekanizmat e mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjislacionit për privatësi, shkëmbim përvojash mbi bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në fushën e privatësisë.

#### Gjatë vitit 2025 janë organizuar dhe mbajtur këto trajnime:

- Niveli profesional i AIP, 2-3-4 prill 2025, IKAP” Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative”
- Niveli i ulët drejtues i AIP, Korrik 2025, IKAP” Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative”
- IKAP,” deklarimi i pasurisë dhe dhuratave-APK”
- Thesar moduli “Zyrtar Shpenzues
- Divizioni për Buxhet dhe Financa dhe të shërbimeve të përgjithshme, 03.03.2025 trajnim on-line me Thesar
- ” Transpozimi i aktit ligjor të BE-së për tregun digjital”



- “Trajnim për rregulloren e përgjithshme të MDHP (GDPR)”

## 4.5 Asetet

### 4.5.1 Asetet në Posedim të Institucionit

Agjencia posedon pasuri jo financiare, e cila është blerë për nevoja pune. Pasuria është e ndarë në dy përmbledhje:

1. Përmbledhja e pasurive jokapitale me vlerë nën €1000 dhe me afat përdorimi edhe për një vit, bazuar në rekomandimet e komisionit të inventarizimit, duke e pasur parasysh se shumica e pasurive janë me vlerë zero. Vlera e tanishme (31.12.2025) pas amortizimit prej **€21,475.50**. AIP ka pajisjet e nevojshme për punë për numrin momental të zyrtarëve të punësuar (kompjuterë, printerë, llap-topë, tavolina pune, ormanë, etj), por paraqitet nevoja urgjente për pajisje të reja në rast të rekrutimit të zyrtarëve të rinj.

Tabela 2. Pasuritë jokapitale (me vlerë nën 1,000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2025	2024	2023
Pajisjet dhe mobiljet	18981.5	31523.0	25586.1
Librat	2,494.0	2,822.9	3151.7
<b>Gjithsej</b>	<b>21475.5</b>	<b>34345.9</b>	<b>28737.8</b>

2. Përmbledhja e pasurive kapitale (me vlerë mbi €1000) në posedim të organizatës buxhetore, gjithsej 36 artikuj me vlerë fillestare të blerjes **€169.212,67** dhe pas largimit të dy veturave sipas Memorandumit të Bashkëpunimit (të bartura në institucion tjetër) tash është 143,514.40€ deri sa vlera e tanishme e pasurisë kapitale pas amortizimit ndër vite është në vlerë prej **€0,00**.

Vlerat e lartcekura janë prerje në fund të vitit kalendarik dhe financiar 2025, d.m.th. deri më datën 31.12.2025, bazuar në raportet e komisioneve për inventarizim dhe vlerësim, si dhe komisionit për pranim dorëzimin e pajisjeve të dëmtuara.

Klasifikimi i pasurive	2025	2024	2023
Ndërtesa			
Toka			
Pajisjet	0	0	0
Infrastruktura			
Makineria			
Automjetet	0	0	0
Tjera			
<b>Gjithsej</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

### 4.5.2 Planet për Asete të Reja

Agjencia është e vendosur në objekt shtetëror, me adresë të institucionit - Rr. “Zejnel Salihu” Nr.22-Kati I, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, në katin e parë të ish Gjykatës Themelore të Prishtinës nga shtatori i vitit 2020. Në bazë të kërkesave të vazhdueshme për plotësim të



personelit si dhe për personelin aktual parashikohet nevoja për blerje të reja të pajisjeve për punë (kompjuterë, skanerë, printerë, tavolina pune, orendi, etj.). Përveç kësaj, hapësira ekzistuese nuk plotëson kushtet e nevojshme fizike për funksionimin e saj, kur kemi parasysh rritjen e numrit të personelit, për çka duhet të sigurohet hapësirë shtesë, e cila është e domosdoshme.

## 5 Aktivitetet e Agjencisë në vitin 2025

Aktivitetet e Agjencisë për vitin 2025 kanë qenë të orientuara në përmbushjen e objektivave të përcaktuar me Planin e Performancës për vitin 2025, për garantimin e së drejtës së qytetarëve për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të të dhënave personale, avancimin e fushëveprimit ligjor të Agjencisë, si dhe përmbushjen e obligimeve ndërinstitucionale në dimensionin ndërkombëtar përfshirë edhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

### 5.1 Aktivitetet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Në fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Agjencia në kuadër të autorizimeve ligjore ka realizuar: inspektime dhe kontrole sipas detyrës zyrtare dhe sipas ankesë, shqyrtim të ankesave, përgatitje të raporteve dhe nxjerrje të vendimeve, ndërgjegjësim të kontrolluesve dhe qytetarëve përfshirë hartim dhe publikim të udhëzuesve për zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave dhe trajnime për zyrtarët e mbrojtjes, autorizime për transfere ndërkombëtare dhe këshilla për qytetarët dhe institucionet publike dhe private.

#### 5.1.1 Inspektimi dhe Kontrolli

Agjencia ka kompletuar tërë kornizën e nevojshme për realizimin e inspektimeve dhe kontroleve. Në kuadër të kësaj, Agjencia ka hartuar Rregulloren për Inspektim, Rregulloren për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave, Listën e Kontrollit dhe Formularin e Procesverbalit.

Numri i inspektimeve sipas detyrës zyrtare për periudhën Janar – Dhjetor 2025, është dyqind e njëzet e gjashtë (226) inspektime sipas detyrës zyrtare

Sektorët në të cilët janë realizuar inspektimet sipas detyrës zyrtare:

- Shtatëmbëdhjetë (17) janë për kontrollues publik
- Dyqind e nëntë (209) për kontrollues privat.


Fushat në të cilat janë realizuar inspektimet;

- Dy (2) inspektime lidhur me shpërndarje të dhënave personale.
- Gjashtë (6) inspektime lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale
- Tetë (8) inspektime lidhur me publikimin e të dhënave personale.
- Dy (2) përpunimi i karakteristikave biometrike
- Njëqind e gjashtëdhjetë e një (161) inspektime lidhur me përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë.
- Katër dhjetë e një (41) në sektorin shëndetësor, laboratore, lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale
- Tre (3) inspektime në sektorin e sigurimeve shëndetësore.
- Tre (3) inspektim lidhur me rrjedhjen e të dhënave personale.




Numri i vendimeve për këtë periudhë është njëqind e nëntëdhjetë e nëntë (199) vendime sipas detyrës zyrtare.

1. Gjobë është shqiptuar në vlerë prej 20,000 euro për publikimin e të dhënave personale të nga Universiteti “Isa Boletini”.
2. Gjobë lidhur me vëzhgimin me kamerë për kontrolluesin “Proex-Interex” në vlerë prej 8.000 euro lidhur me vëzhgimin me kamerë.
3. Gjobë e shqiptuar në vlerë 25.000 euro, për publikim e të dhënave personale ndaj kontrolluesit “ KESCo” Prishtinë.



Paraqitja grafike krahasimore e inspektimeve për vitin 2021, 2022, 2023 ,2024 dhe 2025



Paraqitja grafike krahasimore e inspektimeve sipas detyrës zyrtare dhe inspektime sipas ankesës për vitin 2021,2022,2023,2024 dhe 2025




### 5.1.2 Ankesat

Gjatë vitit 2025, janë pranuar gjithsej njëqind e pesëdhjetë e tetë (158) ankesa prej të cilave njëqind e tridhjetë e nëntë (139) janë përfunduar me vendim dhe në shqyrtim kanë mbetur nëntëmbëdhjetë (19) ankesa.

Natyra e ankesave janë:

- Vëzhgim me kamerë pesëdhjetë e dy (52) ankesa
- Marketing i drejtpërdrejtë njëzet e shtatë (27) ankesa
- Keqpërdorim i të dhënave personale dymbëdhjetë (12) ankesa
- Kërkesë për qasje në të dhëna personale tetë (8) ankesë
- Shpërndarje e të dhënave personale nëntë (9) ankesa
- Publikim i të dhënave personale tridhjetë e tre (33) ankesa
- Kërkesë për fshirjen e të dhënave dy (2) ankesa
- Lidhur me masat e sigurisë një (1) ankesë
- Përpunim i të dhënave pa bazë ligjore katërbëdhjetë (14) ankesa



Paraqitja grafike krahasimore e ankesave të pranura 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025

Gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë njëqind e katerdhjetë e një (141) vendime në bazë të ankesave prej të cilave njëqind e njëzet e nëntë (129) vendime janë nxjerrë për ankesat e vitit 2025 ndërsa dymbëdhjetë (12) vendime janë nxjerrë për ankesat e pranura në vitin 2024.

Gjatë shqyrtimit të ankesave janë shqiptuar shtatë gjopa për kontrolluesin Asistenca Rrugore në vlerë prej 4.000 euro, Kompania e Ujësjellësit Rajonal Prishtina në vlerë 25.000 euro, Natyra Terapi prej 4.000 euro, Autoritet i Konkurrencës në vlerë 20.000 euro, Portali Sinjali në vlerë 20.000 euro, kompania Hebs Sh.P.K në vlerë 4.000 dhe kompania RoadSide Assistance Kenguri Sh.P.K në vlerë 4.000 euro.

Numri i inspektimeve sipas detyrës zyrtare në total është 226 inspektime.


Numri i inspektimeve sipas ankesës është 141 inspektime.

Në total inspektime janë gjithsej 367 inspektime.


Numri i vendimeve në total për vitin 2025 është 340 vendime.

### 5.1.3 Përgatitja e raporteve dhe nxjerrja e vendimeve

Në realizim të detyrave të saj në fushën e mbrojtjes së të dhënave, Agjencia ka nxjerr vendime për kontrolluesit. Gjatë vitit 2025, Agjencia ka nxjerrë treqind e katërdhjetë (340) vendime.




Paraqitja grafike krahasimore e vendimeve ndaj institucioneve publike dhe private për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025



Paraqitja grafike krahasimore e vendimeve ndaj institucioneve publike dhe private për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025

Nga treqind e katërdhjetë (340) vendime, tridhjetë (30) vendime janë lëshuar ndaj institucioneve publike dhe dyqind e dhjetë (210) ndaj institucioneve private.

Në mesin e vendimeve janë shqiptuar dhjetë (10) gjopa kundërvajtësve me shumë totale njëqind e tridhjetë e katër mijë (134,000.00) euro. Tre (3) nga këto gjopa janë shqiptuar ndaj kontrolluesve publik dhe shtatë (7) gjopa ndaj kontrolluesve privat. Të hyrat nga gjopat e shqiptuara nga zbatimi i ligjit për MDHP për vitin 2025 janë €32,500.00€ duke e përfshirë edhe një gjopë në vlerë të paguar 4,000.00€ (gjopë kundërvajtësve e shqiptuar në vlerë 8,000.00€ dhe e paguar brenda afatit ligjorë 50%) nga viti 2024 që është paguar në vitin 2025.



Paraqitja grafike e gjobave të shqiptuara ndaj institucioneve publike dhe private për vitet 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025

Agjencia në vitin 2025 gjatë kryerjes së inspektimit ka pasur për fokus inspektimin e kontrolluesve në aspektin e përpunimit të të dhënave personale në sektorin e kompanive të sigurimeve shëndetësore, laboratorëve, fushën e telekomunikimeve në organet publike qendrore dhe lokale, si dhe në sistemin e vëzhgimit me kamerë ku në masë është konstatuar se kontrolluesit nuk kanë pasur njohurit e duhura rreth përmbushjes së obligimeve ligjore lidhur me kriteret e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë. Me këtë rast, Agjencia nëpërmjet zyrtarëve të inspektimit ka ndërmarrë masat e duhura duke urdhëruar kontrolluesit që brenda një afatit të përcaktuar t'i plotësojnë kriteret e parapara legjislative dhe administrative. Nga këta kontrollues zyrtarët e inspektimit kanë pranuar njoftimet se të njëjtit kanë zbatuar vendimet e Agjencisë.

#### 5.1.4 Trajnimet - Mbrojtja e të dhënave personale

Në kuadër të ndërgjegjësimit, informimit dhe bashkëpunimi me institucionet publike për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia gjatë vitit 2025 ka organizuar trajnime me kontrollues publik dhe privatë me përfshirje të gjerë të institucioneve me qëllim të që të sigurohet zbatimi i Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të ndërmerren masat për mbrojtjen e të dhënave personale në institucione.

Në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë OSBE-së ka organizuar pesë (5) punëtori me temën **“Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin shëndetësor”** me profesionistët shëndetësor të Republikës të Kosovës.

Duke e konsideruar si një nga fushat të rëndësishme të veçantë, sistemin shëndetësor me qëllim të ndërgjegjësimit dhe informimit të punonjësve shëndetësorë, ka organizuar punëtori me Drejtorët e Drejtorive Komunale të Shëndetësisë, Drejtorë të QKMF-ve, QKM-ve, AMF-ve, Drejtor të Urgjencës, mjek, kryeinfermier, infermier, laborant me pjesërrje të përfshqësuesve të (29) njëzet e nëntë Komuna të Republikës së Kosovës, nga Komuna Mitrovicës, Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Vushtrrisë, Skenderaj, Zubin Potokut, Gjilanit, Kamenicës, Ferizaj, Kaçanikut,



Vitisë, Prizrenit, Suharekës, Mamushës, Rahovecit, Malishevës, Dragashit, Pejës, Gjakovës, Deçanit, Istogut, Junikut, Prishtinës, Fushë Kosovës, Graçanicës, Obiliqit, Drenasit, Lipjanit dhe Podujevës.

Gjithashtu në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit, për zbatimin e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e te dhënave personale, në bashkëpunim me në Asociacionin e Komunave të Kosovës është organizuar punëtorja dy ditore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale në nivelin lokal.

Po ashtu gjatë muajit Qershor Agjencia për Informim dhe Privatësi në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, ka mbajtur edhe një punëtori të mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE-ja me **“Sektorin e Mediave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”**, ku ishin të pranishëm 11 gazetarë dhe morën njohuritë e duhura sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ndërsa në kuadër të projektit **“Fuqizimi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Sigurisë Kibernetike në të gjithë sektorët në Kosovë”** janë zhvilluar 6 sesione informues për **“Forcimin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Nivel Lokal”**. Ky projekt është mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi dhe ka përfshirë pjesëmarrje nga regjioni i Gjilanit, Pejës, Mitrovicës dhe Prizrenit, Ferizaj dhe Konferenca përmblylëse në Prishtinë ku kanë marr pjesë 216 zyrtarëve.

Në kuadër të projektit **“MATRA”**, në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Holandës janë zhvilluar 3 trajnime certifikuese mbi **Bazat e Mbrojtjes së të Dhënave Personale**, për zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave personale të nivelit qendror, me pjesëmarrjen e 65 zyrtarëve, ku pjesëmarrësve iu ofrua mundësia e certifikimit nga **TRECCERT**, i cili është një organ ndërkombëtar i njohur për vlerësimin e njohurive dhe aftësive në mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfaqësuar një standard të lartë profesional për zyrtarët publik. Në kuadër të projektit MATRA është përgatitur Udhëzuesi për mbrojtjen e te dhënave personale në Organizatat Jo – Qeveritare.

Në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Agjencia ka organizuar trajnimet për zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale të institucioneve publike, të nivelit qendror dhe lokal, institucioneve të pavarura, agjencive ekzekutive dhe rregullatore, ndërmarrjeve publike, për 138 zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale nga institucionet.

Nga Kompania Rajonale e Ujësjesit janë trajnuar 50 persona po ashtu është mbajtur edhe një punëtori me KRU Mitrovica nga e cila janë trajnuar 20 zyrtarë.

Një trajnim i veçantë është organizuar për Kolegjiumin e Drejtorëve të institucioneve parashkollore ka kanë marrë pjesë 58 persona e cila është organizuar në bashkëpunim me MASHT-in dhe UNICEF.

Në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial janë mbajtur dy trajnime përfshirë regjionin e Prishtinës dhe një për regjionin e Prizrenit, ku morën pjesë 90 përfaqësues përfshirë prokurorë të prokurorive themelore, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor.

Në totalin e realizimit të planit për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve, për të siguruar zbatimin e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë vitit 2025, Agjencia ka ofruar programe të trajnimit për gjithsejtë 807 zyrtarë.



### 5.1.5 Mbrojtja e të dhënave personale në diskursin publik dhe medial

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me komunitetin medial, respektivisht, mbrojtjen e të dhënave personale në media, Agjencia për Informim dhe Privatësi në bashkëpunim me qëllim të ndërgjegjësimit dhe informimit të mediave për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve ka realizuar aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetin medial me qëllim të promovimit të mekanizmave dhe detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve.

Në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, gjatë vitit 2025, Agjencia ka realizuar 21 takime me përfaqësues të mediave në Kosovë me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të mediave për obligimet ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, forcimin e dialogut institucional dhe krijimin e një baze të qëndrueshme bashkëpunimi ndërmjet AIP-së dhe sektorit të mediave. Takimet janë realizuar me mediat-Insajderi, Lajm.net, Radio Televizioni 21, Info Sot, Infokusi, Arbresh, Reporter, Telegrafi, Klan Kosova, ATV, Ekonomia Online, Radio Televizioni i Kosovës, Agjencia e Lajmeve Kosova Press, Kohavisioni, Nacionale, Epoka e Re, Televizioni 7, Gazeta Express, Indeks Online, Dukagjini dhe Kallxo.com.

Po ashtu në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës dhe Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, me mbështetjen e OSBE-së, AIP organizoi punëtorinë “Mbrojtja e të dhënave personale në sektorin e mediave”, me pjesëmarrjen e 15 gazetarëve nga medime të ndryshme të Kosovës.

Në bashkëpunim me Qendrën Mediale në Çagllavicë, është organizuar diskutimi një ditë me editorët dhe gazetarët e mediave në gjuhën serbe në Kosovë me temën “Kush e rrezikon më shumë privatësinë e qytetarëve – institucionet, mediat apo platformat digjitale?”, ku u diskutua për detyrimet ligjore të mediave, transformimi digjital dhe mbrojtja e të dhënave personale në internet.

Me qëllim të informimit dhe ndërgjegjësimit të mediave për mbrojtjen e të dhënave, Agjencia morri pjesë në tryezën “Privatësia dhe Mbrojtja e Identitetit” të organizuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), me fokus mbrojtjen e fëmijëve në media, si dhe në aktivitete të përbashkëta me institucione dhe organizata relevante.

Në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve me institucionet zbatuese të ligjit, me qëllim të përcaktimit të standardeve të bashkëpunimit me mediat në kuptim të ndërmarrjes së veprimeve parandaluese ndaj publikimeve të informatave të paautorizuara, veçanërisht të atyre që kanë të bëjnë me veprime hetimore nga organet kompetente, Agjencia ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me institucionet si në vijim: Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës.

Në kuadër të këtij memorandumi të bashkëpunimit, janë përcaktuar përgjegjësitë dhe zotimet e dhëna nga institucionet e lartpërmendura të cilat janë palë nënshkruese të këtij memorandumi. Në këtë drejtim, institucionet zbatuese të ligjit janë zotuar se do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për parandalimin e shpërndarjes së publikimit të të dhënave personale të cilat i përpunojnë në kuadër të ushtrimit të autoritetit të tyre zyrtar dhe kufizimin e qasjes në këto të dhëna, ndërsa Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës do të angazhohet në veçanti në promovimin e standardeve profesionale dhe respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në veprimtarinë e raportimit medial.



Agjencia për Informim dhe Privatësi si autoritet kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe si palë nënshkruese e këtij memorandum, do të angazhohet në veçanti në ofrimin e mbështetjes profesionale për këto institucione, hartimin e udhëzuesve praktik të mbrojtjes së të dhënave personale në sektorin e mediave, dhe në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës të promovoj ndërgjegjësimin dhe edukimin etik në raportim, në mënyrë që mbrojtja e të dhënave personale të integrohet në standardet e gazetarisë profesionale.

Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të parapara sipas memorandumit të bashkëpunimit, gjatë vitit 2025 janë mbajtur dy (2) takime me të gjitha palët e përfaqësuara, dhe njëkohësisht është përgatitur edhe plani i veprimit për zbatimin e aktiviteteve përkatëse të parapara në memorandum, ndërsa në gjashtëmuorin e parë të vitit 2026 do të themelohet Grupi Punues për përgatitjen e udhëzuesit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Media.

## 5.2 Aktivitetet në fushën e Qasjes në Dokumente Publike


Në funksion të rritjes së transparencës dhe forcimit të llogaridhënies së institucioneve publike, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), në ushtrim të kompetencave të saj ligjore në fushën e qasjes në dokumente publike, ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, AIP ka pranuar dhe shqyrtuar ankesat e qytetarëve me qëllim garantimin e respektimit të së drejtës për informim. Departamenti për Qasje në Dokumente Publike, përmes Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave, ka trajtuar ankesat e paraqitura, ka nxjerrë vendimet përkatëse, ka monitoruar zbatimin e tyre dhe, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, ka hartuar raportin analitik janar-dhjetor 2025.

### 5.2.1 Shqyrtimi i Ankesave për Qasje në Dokumente Publike

Gjatë vitit 2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi ka pranuar gjithsej **927** ankesa nga qytetarët, shoqëria civile dhe mediat, ndërsa ka bartur për shqyrtim edhe **80** ankesa të mbetura nga viti 2024. Në këtë mënyrë, numri total i ankesave të trajtuara ka arritur në **1007** ankesa. Nga ky numër, në proces shqyrtimi janë **175** - ( të cilat janë bartur për shqyrtim në 2026) kurse janë mbyllur **832** ankesa, duke respektuar procedurat e përcaktuara me aktin e brendshëm për shqyrtimin e ankesave.

Është e rëndësishme të theksohet se pjesa më e madhe e ankesave të mbyllura është zgjidhur pas dërgimit të shkresës së parë njoftuese të AIP-së drejtuar institucioneve përkatëse. Përveç kësaj, në kuadër të shqyrtimit të ankesave, AIP ka zhvilluar takime me palët në procedurë me qëllim të përshpejtimit të procesit, lehtësimit të trajtimit të rasteve si dhe ofrimin të sqarimeve të nevojshme për palët e përfshira.




Numri total i ankesave të mbyllura dhe në shqyrtim për vitin 2025

Gjatë periudhës **2021–2025**, në Agjencinë për Informim dhe Privatësi është shënuar një **trend i qëndrueshëm rritjes së numrit të ankesave të parashtruara**, duke reflektuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për të drejtat në fushën e informimit dhe qasjes në dokumente publike.

Në vitin **2021**, janë pranuar gjithsej **139 ankesa**, duke përfaqësuar vitin me numrin më të ulët të ankesave në këtë periudhë. Në vitin **2022**, numri i ankesave është rritur në **421**, duke shënuar një rritje të dukshme krahasuar me vitin paraprak. Ky trend i rritjes ka vazhduar edhe në vitin **2023**, ku janë regjistruar **552 ankesa**, ndërsa në vitin **2024** numri ka arritur në **747 ankesa**.

Krahasuar me vitet e kaluara, numri më i madh i ankesave është shënuar në vitin **2025**, me gjithsej **927 ankesa**, çka paraqet rritjen më të lartë vjetore gjatë gjithë periudhës së analizuar.


Në total, gjatë pesë viteve **2021–2025**, në AIP janë parashtruar **2,786 ankesa**, që paraqet rritje të numrit të ankesave dhe rritje interes gjithnjë më të madh të palëve për adresimin e çështjeve që lidhen me transparencën dhe llogaridhënjes e insitucioneve publike.



Paraqitja grafike e numrit të ankesave të pranuara

Ankesat e parashtruara në AIP gjatë kësaj periudhe kohore të vitit 2021-2025 janë bërë nga këto kategori:

	2021	2022	2023	2024	2025	Total
- Qytetarë	54	207	322	392	519	1,494
- OJQ	77	138	165	216	238	834
- Media	8	76	65	139	170	458




Paraqitja grafike e kategorisë së ankuesve

### 5.2.2 Krahasimi i kategorisë së ankuesve

Nga viti 2021 deri në 2025 vërehet një rritje e theksuar e ankesave në të gjitha kategoritë. Rritja më e madhe numerike vjen nga qytetarët (+465 ankesa ose afërsisht dhjetë herë më shumë sa viti 2021), e pasuar nga mediat (+162 ankesa ose 21 herë më shumë se viti 2021) dhe në fund



nga OJQ (161 ankesa ose rreth 3 herë më shumë se sa viti 2021). Kjo tregon një zgjerim të konsiderueshëm të përfshirjes së qytetarëve dhe medias në paraqitjen e ankesave pranë AIP-së gjatë kësaj periudhe.




Paraqitja grafike e krahasimit të kategorisë së ankuesve 2021 - 2025

### 5.2.3 Institucionet dhe numri i ankesave të parashtruara në AIP gjatë periudhës 2021-2025

Gjatë periudhës 2021–2025, numri i ankesave të paraqitura në AIP ka shënuar rritje të përgjithshme në pothuajse të gjitha kategoritë e institucioneve. Në vitin 2021 numri i ankesave ishte relativisht i ulët, ndërsa nga viti 2022 e tutje evidentohet një rritje e ndjeshme, veçanërisht ndaj dikastereve qeveritare dhe komunave. Këto dy kategori paraqiten vazhdimisht ndër institucionet me numrin më të lartë të ankesave, duke reflektuar kontaktin e drejtpërdrejtë dhe të shpeshtë me qytetarët.

Dikasteret qeveritare ( ministritë) kanë shënuar rritje të numrit të kërkesave, nga viti 2022 deri në 2024, ndërsa në vitin 2025 kanë një rënie të lehtë. Komunitatet regjistrojnë rritje të vazhdueshme, duke arritur kulmin në vitin 2025. Edhe sistemi i drejtësisë ( prokurori dhe gjykata) dhe agjencitë ( te pavarura dhe ekzekutive) kanë luhatur, me rritje të theksuar sidomos në vitet 2023 dhe 2024, çka tregon një shtim të ankesave ndaj këtyre institucioneve gjatë kësaj periudhe.

Institucionet e tjera (shërbimet spitalore, ndërmarrjet publike, institucionet arsimore etj), paraqesin lëvizje të ndryshueshme ndër vite, me rritje të konsiderueshme në vitin 2025. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve për të ushtruar të drejtën e ankesës dhe një intensifikim të rolit mbikëqyrës të AIP ndaj institucioneve publike.



Paraqitja grafike e Institucioneve ndaj të cilave janë parashtruar ankesa 2021 - 2025


#### 5.2.4 Vendimet ndaj ankesave për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi, ka nxjerrë gjithsej 766 vendime lidhur me ankesat e pranuar. Këto vendime janë të shpërndara në kategori të ndryshme, si në vijim:

- **619 vendime përmbyllëse:** Kjo kategori përfshinë shumicën e vendimeve të nxjerra nga AIP, duke treguar që një numër i madh i rasteve është përfunduar përmes një procesi administrativ të plotë.
- **130 vendime refuzuese:** Për shkak të mos respektimit të afateve ligjore.
- **18 raste të gjobës:** Agjencia ka shqiptuar 18 gjoba për moszbatimin e detyrimeve ligjore, nga të cilat: **1** ndaj Këshillit Prokurorial i Kosovës, **3** ndaj Organit Shqyrtues të Prokurimit, **2** ndaj Ministrisë së Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës, **1** ndaj Kompanisë Rajonale Ujësjetësi Gjakova, **1** ndaj UP “Hasan Prishtina”, **1** ndaj Agjencisë Kadastrale të Kosovës, **2** ndaj Komunës së Shtërpçës, **1** ndaj Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, **1** ndaj Agjencisë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK), **1** ndaj KRU Bifurkacioni, **1** ndaj Komunës së Deçanit, **1** ndaj NPL Përparimi, dhe **1** ndaj Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe **1** ndaj Komunës së Prishtinës.



Për të elaboruar më mirë të gjitha këto të dhëna statistikore, mund ti referoheni grafikut 6 dhe tabelës numër 1, të cilat shtjellojnë në detaje të gjitha të dhënat e sipërshtuara.



Paraqitja grafike e vendimeve për ankesat e vitit 2025


### Institucionet ndaj të cilave AIP ka nxjerr vendim me gjobë gjatë vitit 2025

NATYRA E DOKUMENTEVE, OBJEKT KËRKESE TË INSTITUCIONEVE TË GJOBITURA			
Nr	Institucioni / Enti	Shuma (€)	Dokumentet, objekt kërkesë
1	Këshilli Prokurorial i Kosovës	€ 3,000.00	Informata rreth aktakuzave që janë ngritur për secilin prokuror të PSPK-se, numrin e tyre, në çfarë procesi janë, ato që kanë përfunduar si kanë përfunduar, dhe a ka ankesa. (2021.2022.2023. 01/06.2024)
2	Organi Shqyrtues i Prokurimit	€ 3,000.00	Procesverbalin e votimit të panelit shqyrtues
3	Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës	€ 3,000.00	Informacione rreth negociatave dhe ndryshimit të prioritetëve për autostradën Prishtinë-Mendarë
4	Kompania Rajonale Ujësjetësi Gjakova	€ 3,000.00	Dokumente rreth OE fitues të aktivitetit të prokurimit
5	UP "Hasan Prishtina"	€ 3,000.00	Njoftime të kryesuesit, komunikime zyrtare, rendin e ditës së mbledhjes së këshillit drejtues...
6	Agjencia Kadastrale e Kosovës	€ 3,000.00	ofertat e OE, kërkesat e njëjësive kërkuese, komunikimet zyrtare në mes të zyrës së prokurimit dhe OE
7	Komuna e Shtërpçës	€ 8,000.00	Informacione, fatura lidhur me projektin e ndërtimit dhe renovimit të kulmit të Qendres Spitalore në Biti e Poshtme, shpenzimet e kryetarit...
8	Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës	€ 3,000.00	Vendim
9	Organi Shqyrtues i Prokurimit	€ 3,000.00	Procesverbalin e votimit të panelit shqyrtues
10	Organi Shqyrtues i Prokurimit	€ 3,000.00	Procesverbalin e votimit të panelit shqyrtues
11	Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut	€ 3,000.00	Dosjet duke përfshirë raportin e laboratorit doganor lidhur me ri-testimet e Petrol Company, informata mbi mbylljen e procedurave për kompanitë dhe veprimet e ndërmarra nga laboratorit i emëruar testues Kosova lab Sh.A.



12	Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK)	€ 3,000.00	Vendim - adm. për subjektin e te dhënave
13	KRU Bifurkacioni	€ 3,000.00	Procesverbale të takimeve të komisionit për shqyrtimin e ankesave, kopje te kërkesave dhe doc. tjerë administrativ
14	Komuna e Shtërpçës	€ 8,000.00	Pasqyrën e shpenzimeve dhe faturat me kartelën bankare që i shfrytëzon kryetari i komunës gjatë udhëtimeve zyrtare
15	NPL Përparimi	€ 3,000.00	Listen e punetoreve të pranuar nga 01.01.2024 deri 30.06.2025
16	Komuna e Deçanit	€ 3,000.00	Kërkesat e iniciuara së bashku me faturat dhe arsyen lidhur me pagesat e dreka/darka zyrtare), raportin e shpenzimeve të gjeneruara me kartelën e Id përfituesit, për secilin furnitor (pagesat e ndara në raportin e gjeneruar)
17	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	€ 3,000.00	Raportin e komisionit dhe përgjigjen nga Drejtoria e Akreditimit për lëndën me nr. 2874
18	Komuna e Prishtinës	€ 3,000.00	Marrëveshje me Donatorë

Tabela - Vendimet me gjoba për institucionet



Paraqitja grafike e shqiptimit të gjorave për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025


Bazuar në të dhënat e mësipërme (shih grafikun 7), vërehet një trend përgjithësisht në rritje i numrit të gjorave gjatë periudhës 2021–2025, me një ndryshim nga viti në vit.

Në vitin 2021 nuk është regjistruar asnjë gjobë (0). Në vitin 2022 shënohet një rritje fillestare me 4 gjoba, ndërsa në vitin 2023 numri dyfishohet, duke arritur në 8 gjoba. Në vitin 2024 konstatohet një rënie e përkohshme në 6 gjoba, megjithatë kjo nuk e ndryshon trendin e përgjithshëm rritës. Në vitin 2025 evidentohet niveli më i lartë i periudhës, me gjithsej 18 gjoba, që përfaqëson një rritje të ndjeshme krahasuar me vitet paraprake.

Në përmbljedhje, grafiku tregon një intensifikim të dukshëm të masave ndëshkuese nga viti në vit, veçanërisht në vitin 2025, duke reflektuar një qasje më aktive ose më të rreptë në zbatimin e kompetencave përkatëse gjatë kësaj periudhe.



### Krahasimi i llojeve të vendimeve për vitet 2021 – 2025



Paraqitja grafike e Vendimeve për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025

## 5.3 Monitorimi dhe raportimi

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike, Agjencia, në fushën e qasjes në dokumente publike, sipas autorizimeve të saj ligjore, ka vazhduar me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, duke monitoruar faqet zyrtare të institucioneve publike në zbatim të obligimit të institucioneve publike për t'i publikuar me vetiniciativë dokumentet. Në përputhje me detyrimet ligjore dhe me qëllim të sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies Përveç kësaj, Agjencia ka vazhduar të obligojë të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të raportojnë mbi numrin e kërkesave për qasje për periudhën njëvjeçare të vitit paraprak. Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe institucioneve publike mbetet si një prej prioriteteve strategjike të AIP-së. Monitorimi i faqeve zyrtare të Institucioneve Publike, si një prej autorizimeve ligjore të AIP-së, gjatë vitit 2025, sipas planifikimit, është bërë përgjatë gjithë vitit.

### 5.3.1 Monitorimi i ueb faqeve zyrtare të Institucioneve Publike

Metodologjia e përdorur përgjatë monitorimit mund të përshkruajmë në mënyrë kuantitative e transparencës institucionale përmes vlerësimit të përmbajtjes së faqeve zyrtare të institucioneve publike. Monitorimit i vazhdueshëm, regjistrimi sistematik i të dhënave dhe analiza statistikore për të vlerësuar transparencën e institucioneve sigurojnë në mënyrë objektive dhe të matshme zbatimin e detyrimeve ligjore në publikimin e dokumenteve. Gjatë mbledhjes së të dhënave, nga monitorimi i vazhdueshëm bëhet identifikimi i përmbushjes ose jo të kriterit i nenit 5 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje i cili parasheh që janë rreth njëzet e një (21) dokumente që institucionet publike detyrohet të publikojnë në mënyrë proaktive. Gjatë vlerësimit janë përdorur tregues të qartë, ku dokumentet e publikuara janë shënuar me vlerën 1, ndërsa ato të pa publikuara me vlerën 0, të dhënat e mbledhura përpunohen duke llogaritur përqindjen e dokumenteve të publikuara në raport me totalin e kërkuar, shuma totale e pikëve shndërrohet



në përqindje, e cila reflekton nivelin e publikimit të dokumenteve nga institucionet e monitoruara. Rezultatet përfundimtare janë të paraqitura në tabela ku përmes përqindjeve janë të ndarë niveli qendror, komunal dhe institucioneve të pavarura. Si rezultat i këtij procesi, janë dërguar njëqind e pesëdhjetë e tetë (158) raporte monitorimi institucioneve përkatëse, të cilat përmbanin të gjeturat si dhe rekomandimet për publikimin me vetiniciativë.

Për të siguruar transparencë të plotë në punën e tyre edhe sa i përket qasjes në dokumente publike, institucionet publike, përmes zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike, hartojnë një raport vjetor më së largu deri në fund të muajit janar të vitit aktual, për periudhën deri në datën 31 dhjetor të vitit paraprak, ku përfshihet numri i rasteve, në të cilat, institucioni publik ka lejuar qasjen, numrin e rasteve në të cilat institucioni publik ka refuzuar qasjen në dokumente, si dhe arsyet e këtyre refuzimeve.

Të dhënat e paraqitura në vijim ofrojnë një analizë të strukturuar të nivelit të proaktivitetit të faqeve zyrtare të institucioneve publike, duke filluar nga viti 2023 – periudhë kjo që përfaqëson një moment të rëndësishëm në forcimin e qasjes institucionale ndaj monitorimit . Me funksionalizimin e Divizionit për Raportim dhe Monitorim gjatë këtij viti, është konsoliduar një metodologji më e qartë, e standardizuar dhe e matshme për vlerësimin e publikimit proaktiv të dokumenteve.

Kjo qasje është zhvilluar në përputhje me mandatin dhe autorizimet ligjore të Agjencia për Informim dhe Privatësi, si dhe me kuadrin e përgjithshëm ligjor në fuqi që rregullon transparencën dhe qasjen në dokumente publike. Përmes vendosjes së treguesve të matshëm, analizës krahasuese dhe raportimit, monitorimi ka kaluar nga një proces formal evidentimi në një mekanizëm funksional të vlerësimit të performancës institucionale në fushën e transparencës.

Të dhënat krahasimore për periudhën 2023–2025 dëshmojnë një rritje të qëndrueshme të nivelit të transparencës në shumicën e kategorive institucionale.

Institucionet Qendrore kanë shënuar rritje nga 48.40% në vitin 2023, në 49.62% në vitin 2024, ndërsa në vitin 2025 kanë arritur 69.70% publikim proaktiv, duke shënuar rritje prej mbi 21 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023.

Agjencitë Vartëse kanë kaluar nga 37.00% në vitin 2023 dhe 37.38% në vitin 2024, në 54.28% në vitin 2025, duke reflektuar progres të dukshëm institucional.

Institucionet e Pavarura kanë shënuar një nga përmirësimet më të theksuara, nga 44.58% në vitin 2023, në 61.69% në vitin 2024, dhe 80.29% në vitin 2025.

Komunat kanë treguar rritje të vazhdueshme nga 55.20% në vitin 2023, në 58.80% në vitin 2024, ndërsa në vitin 2025 kanë arritur nivel shumë të lartë të publikimit proaktiv prej 86.51%.


Gjykatat dhe Prokuroritë kanë avancuar nga 50.30% në vitin 2023, në 52.50% në vitin 2024, duke arritur 87.99% në vitin 2025, që paraqet një nga përmirësimet më të mëdha në periudhën raportuese.

Universitetet publike kanë përmirësuar nivelin e publikimit nga 57.10% në vitin 2023, në 66.67% në vitin 2024, dhe 72.02% në vitin 2025.



Ndërmarrjet Publike kanë shënuar rritje nga 48.06% në vitin 2023, në 52.06% në vitin 2024, dhe 64.33% në vitin 2025.

Në përgjithësi, viti 2025 karakterizohet me përmirësim të theksuar të publikimit proaktiv në të gjitha kategoritë institucionale, duke reflektuar efektin e drejtpërdrejtë të monitorimit, adresimit të rekomandimeve dhe rritjes së përgjegjësisë institucionale ndaj transparencës.



Paraqitje grafike e përqindjes së respektimit të nenit 5 të Ligjit 06/L-081 për QDP nga institucionet publike të Republikës së Kosovës për vitin 2023, 2024 dhe 2025

Publikimi më vetiniciativë ka qenë edhe përqendrimi kryesor i fushatës ndërgjegjësuere që Agjencia ka organizuar në kuadër të Javës së Lirisë së Informimit, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtës Universale për Qasje në Dokumente Publike, me institucione publike të nivelit qendror dhe lokal, si dhe me përfshirjen e OJQ-ve vendore dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në vend. Rëndësia e publikimit me vetiniciativë të dokumenteve publike lidhet me uljen e numrit potencial të kërkesave për qasje në dokumente publike, me të cilat do të përballëshin institucionet e të gjitha niveleve, e rrjedhimisht edhe shkarkimin e Agjencisë nga ankesat e mundshme nga qytetarët për kufizimin apo refuzimin e qasjes në dokumente publike.

### 5.3.2 Kërkesat për qasje në dokumente publike ndaj institucioneve

Nga të dhënat e raportimit vjetor për periudhën 2021–2025 pranë Agjencia për Informim dhe Privatësi, evidentohet një progres i qartë në përmbushjen e obligimit ligjor për raportim nga institucionet publike lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike.

Në vitin 2021, nga gjithsej 162 institucione publike, kanë raportuar 103 institucione, ndërsa 59 nuk kanë raportuar. Prej institucioneve raportuese, 6 kanë deklaruar se gjatë vitit nuk kanë pasur kërkesa për qasje në dokumente publike.




Në vitin 2022, nga 171 institucione gjithsej, kanë raportuar 87 institucione, ndërsa 84 nuk kanë raportuar. Nga këto, 5 institucione kanë raportuar se nuk kanë pasur kërkesa për qasje në dokumente publike.

Në vitin 2023 shënohet një përmirësim i dukshëm: nga 167 institucione gjithsej, kanë raportuar 159 institucione, ndërsa vetëm 8 nuk kanë raportuar. Nga institucionet raportuese, 26 kanë deklaruar se gjatë vitit nuk kanë pasur kërkesa për qasje.

Në vitin 2024 është arritur raportim i plotë. Nga 175 institucione gjithsej, të gjitha 175 kanë raportuar pranë Agjencisë. Prej tyre, 18 institucione kanë njoftuar se gjatë vitit nuk kanë pasur asnjë kërkesë për qasje në dokumente publike.

Ky nivel i lartë i përmbushjes së obligimit është ruajtur edhe në vitin 2025. Nga 175 institucione gjithsej, kanë raportuar 174 institucione, ndërsa vetëm 1 nuk ka raportuar. Nga institucionet raportuese, 15 kanë deklaruar se gjatë vitit nuk kanë pasur kërkesa për qasje..

Analiza ndërvite 2021–2025 tregon një rritje progresive të përgjegjshmërisë institucionale, me ulje të ndjeshme të numrit të institucioneve jo-raportuese dhe me arritjen e raportimit të plotë në dy vitet e fundit, çka reflekton forcimin e kulturës së llogaridhënies dhe respektimit të obligimeve ligjore në fushën e qasjes në dokumente publike.. Agjencia konsideron se qasja këmbëngulëse e zyrtarëve të divizionit të monitorimit dhe raportimit ndaj institucioneve publike, si dhe fushata e takimeve ndërgjegjësuere e zhvilluar gjatë vitit nga ana e Komisioneres, kanë ndikuar që institucionet t'i përgjigjen obligimit për raportim vjetor.



Paraqitja grafike e raportimit vjetor të institucioneve për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025

Pas mbledhjes dhe evidentimit të të dhënave për periudhën raportuese 2021–2025 nga institucionet publike që kanë raportuar pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, paraqitet kjo pasqyrë krahasimore e numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe mënyrës së trajtimit të tyre ndër vite:



Për vitin 2021, numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike ka qenë 7561. Prej tyre, ndaj 7408 kërkesave është ofruar qasje e plotë, ndaj 46 kërkesave është ofruar qasje e pjesshme, ndërsa 95 kërkesa janë refuzuar.

Në vitin 2022, numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar ka qenë 4481. Nga këto, për 3893 kërkesa është ofruar qasje e plotë, për 409 kërkesa është ofruar qasje e pjesshme, ndërsa 154 kërkesa janë refuzuar.

Në vitin 2023, sipas të dhënave të raportuara nga institucionet publike, numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje ka qenë 4465, prej të cilave për 4060 kërkesa është ofruar qasje e plotë, për 180 kërkesa është ofruar qasje e pjesshme, ndërsa 225 kërkesa janë refuzuar.

Gjatë vitit 2024, numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike ka qenë 5515. Prej tyre, ndaj 5021 kërkesave është ofruar qasje e plotë, ndaj 253 kërkesave është ofruar qasje e pjesshme, ndërsa 241 kërkesa janë refuzuar.

Ndërkaq, për vitin 2025 evidentohet një rritje e theksuar e numrit të kërkesave, ku numri i përgjithshëm arrin në 8997 kërkesa për qasje në dokumente publike. Prej tyre, për 8279 kërkesa është ofruar qasje e plotë, për 468 kërkesa është ofruar qasje e pjesshme, ndërsa 250 kërkesa janë refuzuar.

Paraqitja grafike në vijim pasqyron në mënyrë krahasimore trendin e numrit të përgjithshëm të kërkesave për qasje në dokumente publike, si dhe mënyrën e trajtimit të tyre (qasje e plotë, qasje e pjesshme dhe refuzim) gjatë viteve 2021–2025, duke reflektuar ndryshimet vjetore dhe nivelin e transparencës së institucioneve publike në raport me të drejtën për qasje në dokumente publike.

Nga përmbledhja e përgjithshme e raportimeve të institucioneve publike në Kosovë, është vërejtur rritje e ndërgjegjësimit të përgjithshëm nga institucionet qendrore, komunat dhe institucionet e pavarura, që të gjitha kanë raportuar pranë Agjencisë. Lista e institucioneve publike që kanë raportuar pranë AIP-së, si dhe lista e institucioneve që nuk kanë pasur kërkesa për qasje në dokumente publike është e paraqitur në shtojcën e mëposhtme.




Tabela krahasuese e kërkesave për QDP ndaj institucioneve publike në nivel vendi për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025



## 5.4 Aktivitetet në fushën ligjore të Agjencisë

Aktivitetet në fushën ligjore janë organizuar në kuadër të organizimit të brendshëm të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, duke u bazuar në mandatin e përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe përgjegjësitë e parapara me Rregulloren Nr. 01/2021 (AIP) për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, gjatë vitit 2025 ka arritur të realizoj mandatin e saj, sipas detyrave dhe përgjegjësiave të përcaktuara.

### 5.4.1 Legjislacioni

Bazuar në mandatin dhe fushëveprimin ligjor, gjatë vitit 2025, Agjencia ka përgatitur respektivisht ka ofruar mbështetje nga aspekti ligjor, për përgatitjen e akteve juridike, si në vijim:

#### Projektligje:

- Projektligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga Institucionet e Zbatimit të Ligjit – Gjatë vitit 2025 është përgatitur drafti i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga Institucionet e Zbatimit të Ligjit. Në kuadër të këtij procesi, janë zhvilluar komunikimet e nevojshme me ekspertët e angazhuar nga Zyra e Këshillit të Evropës për mbështetje të këtij procesi, janë zhvilluar konsultimet paraprake dhe publike me institucionet kompetente, ku veçmas kësaj, projektligji po ashtu është përfshirë në platformën elektronike të konsultimeve publike të Qeverisë. Me përfundimin e procedurave të mësipërme, Agjencia për Informim dhe Privatësi ka inkorporuar komentet e pranuar, dhe aktualisht ky projektligj është në fazën finale, ku njëkohësisht i njëjti është paraparë edhe në kuadër të Planit të Projektligjeve të Qeverisë të vitit 2026, ku gjatë këtij viti edhe pritet procedimi i tij për aprovim nga Qeveria.

#### Akte nënligjore:

- Rregullore Nr. 01/2025 për procedurën e brendshme të shqyrtimit të ankesave për qasje në dokumente publike. Kjo rregullore është nxjerrë në pajtim me rregullativën ligjore të paraparë sipas Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ku neni 20 paragrafi 3 i këtij ligji, ndër të tjera parasheh se ...” Agjencia, me akt të brendshëm, vendosë për procedurën dhe mënyrën e vendosjes brenda këtij institucioni. Pas përfundimit të të gjitha procedurave përkatëse, kjo rregullore është aprovuar nga Komisionerja me datë 26.03.2025.

#### Udhëzuesit:

- Akti i brendshëm për masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Udhëzues për sektorin shëndetësor;
- Udhëzuesi për vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave;
- Udhëzues për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.




## Memorandumet e Bashkëpunimit:

- Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe Forumit Kosovar për Aftësi të Kufizuar;
- Memorandum i bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Zyrës së Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor, Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës;
- Memorandum Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe Universitetit “Aristotle” në Selanik;
- Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe NGO AKTIV.

### 5.4.2 Këshillat ligjore


Gjatë vitit 2025, Agjencia ka përgatitur dhe ofruar 58 këshilla ligjore, ku prej tyre njëzetë e nëntë (29) këshilla janë lëshuar për institucionet publike, shtatëmbëdhjetë (17) për institucionet nga sektori privat, si dhe dymbëdhjetë (12) këshilla janë lëshuar për persona fizik përkatësisht qytetarët, sipas kërkesës së tyre drejtuar Agjencisë.



Këshillat ligjore për Institucionet Publike, Private dhe personat fizik



## RAPORT STATISTIKOR LIDHUR ME KËSHILLAT LIGJORE TË OFRUARA NDËR VITE NGA DEPARTAMENTI LIGJOR




Këshillat ligjore për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025

### 5.4.3 Përfaqësimi Gjyqësor

Në përgatitjen e përgjigjeve në padi, ankesave në Gjykatë të Apelit dhe përfaqësimit të Agjencisë në procese gjyqësore, numri i përgjithshëm nga ky proces në periudhën raportuese është si vijon:

- Përgjigje në padi – gjashtëmbëdhjetë (16) përgjigje në padi
- Ankesa në Gjykatë të Apelit – dy (3) Ankesa
- Përfaqësim në Gjykatë – dhjetë (10) përfaqësime në Gjykatën Themelore në Prishtinë.



Përfaqësimet gjyqësore

### 5.4.4 Vendimet për Autorizim të përdorimit të karakteristikave biometrike

Agjencia për Informim dhe Privatësi, gjatë vitit 2025, ka nxjerr Vendimin Nr. 29/2025 i datës 14.07.2025 për lejin e autorizimit për përdorimin e karakteristikave biometrike për



kontrolluesin “Raiffeisen Tech Kosova” Prishtinë, me qëllim të përdorimit të “Ëindoës Hello for Bussiness” si teknologji autentifikimi e cila mundëson identifikimin e përdoruesve të kompjuterëve duke përdorur të dhënat biometrike.

#### 5.4.5 Transferimi i të Dhënave Personale

Gjatë vitit 2025, janë trajtuar dhe shqyrtuar kërkesa për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, duke siguruar përputhshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me standardet përkatëse ndërkombëtare të mbrojtjes së privatësisë.

Si rezultat i këtij procesi, gjatë vitit 2025 janë lëshuar **gjithsej gjashtë (5) vendime autorizuese** për transferimin e të dhënave personale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, si në vijim:

- Kontrolluesi “**LC WAIKIKI RETAIL KOSOVO**”, në Prishtinë tek Përpunuesi “LC Ëakiki Magazacilik Hizmetleri Ticaret Anonim Sirketi” Republika e Turqisë.
- Kontrolluesi “**Toypa Kosova JSC**”, në Prishtinë tek Përpunuesi “Sunman Sanayi Mamulleri Ithalat Ihracat ve Ticaret Anonim Sirketi” Republika e Turqisë.
- Kontrolluesi “**T.C. Ziraat Bankası A.Ş.**”, në Prishtinë tek Përpunuesi “**Paylink Sh.A.**” Republika e Turqisë në Republikën e Turqisë.
- Kontrolluesi “**Banka Raiffeisen**”, në Prishtinë tek Përpunuesi “Wise Europe Sa” në **Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të Evropës.**
- Kontrolluesi “**Ziraat Bank Kosova Sh.A.**”, në Prishtinë tek Përpunuesi “**T.C. Ziraat Bankası A.Ş.**” në **Republikën e Turqisë.**

### 5.5 Sfidat

Performanca e përgjithshme e Agjencisë për Informim dhe Privatësi gjatë këtij viti është karakterizuar me sfida të ndryshme, nisur nga mungesa përkatësisht nevoja për shtimin e numrit të zyrtarëve kryesisht dhe sigurimit të ekspertizës profesionale, të avancuar, krahas trajtimit të ankesave për qasje në dokumente publike, ankesave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurimin e stafit të specializuar për inspektime dhe kontrole në fusha specifike.

Rritja e numrit të stafit dhe forcimi i ekspertizës profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, paraqet sfida të vazhdueshme të Agjencisë. Agjencia në veçanti ka identifikuar vështirësi në realizimin e procesit të inspektimeve (inspektimet sipas ankesës dhe sipas detyrës zyrtare) në institucionet publike dhe private veçanërisht në sektorin shëndetësor, të cilat në kuadër të fushëveprimit të tyre përpunojnë të dhëna personale (të ndjeshme). Mungesa e stafit të specializuar për realizimin e inspektimeve, paraqet dhe vështirësi në realizimin e veprimeve të Agjencisë në përmbushjen e objektivave të saj dhe rrjedhimisht zbatimin e detyrimeve ligjore të Agjencisë në raport me mbrojtjen e të dhënave personale



Numri në rritje i ankesave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në informacion, nga viti 2023, 2024 dhe 2025 paraqet gjithashtu sfidë dhe vështirësi serioze në zbatimin e objektivave dhe legjislacionit të Agjencisë dhe pamundëson respektimin e afateve kohore për trajtimin e ankesave për qasje në dokumente publike sipas standardeve ligjore.

Marrë parasysh të dhënat e prezantuar në raport, Agjencia për Informim dhe Privatësi, ka adresuar kërkesën pranë Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve që të shqyrtojë mundësinë e shtimit të numrit të inspektorëve dhe zyrtarëve përgjegjës të cilët shqyrtojnë ankesat sipas fushëveprimit të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në planifikimet organizative për vitin 2025 dhe 2026 për realizimin e fushëveprimit të Agjencisë dhe zbatimin e ligjit, Agjencia ka nevojë të plotësohet me gjithsejtë 48 pozita, nga 34 të aprovuarat për vitin 2025 në veçanti shtimin e numrit të stafit të specializuar në inspektime dhe kontrole përfshirë sigurimin e ekspertizës profesionale në fushën e teknologjisë informativ.

Numri i rritjes së personelit është i domosdoshëm si dhe shtimi i buxhetit në mallra dhe shërbime për vitin 2025 në shumën prej 40.000,00 euro krahasuar në planifikimin aktual prej 144.000,00€ për organizimet e planifikuara, me karakter ndërkombëtar, si konferencat të organizuara në Republikën e Kosovës, pajisjet e nevojshme për punë dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, përkatësisht trajnimet për personelin e Agjencisë.

Fokus me interes për Agjencinë, mbetet forcimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian dhe organizmave tjerë që veprojnë në fushën e informimit dhe privatësisë.

Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar do të vazhdojë shqyrtimin e mundësive për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale dhe në fushat:

- Shkëmbimin e përvojave në fushën e zhvillimeve të reja teknologjike;
- Aplikimi në projektet e financuara nga Bashkimi Evropian;
- Përfaqësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe prezantimi i të arriturave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike
- Shkëmbimin e informacionit në dispozicion të publikut në lidhje me standardet e reja evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike;
- Shkëmbimi i ekspertëve me qëllim të studimit të tipareve të funksionimit të sistemit institucional të mbrojtjes së të dhënave personale përkthazi me nevojat shtetërore

Po ashtu, sfidë e Agjencisë vazhdon të mbetet mos implementimi i drejtpërdrejtë i Konventës 108+ për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale si një nga faktorët e nevojshëm në kompletimin e kornizës ligjore, përkatësisht harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian, për sa i përket fushës së mbrojtjes së të dhënave personale.



Ekspertiza profesionale e specializuar në fushën e teknologjisë informative mbetet sfidë e vazhdueshme e Agjencisë në mënyrë që procesi i inspektimeve dhe kontrolleve për mbrojtjen e të dhënave personale të realizohet me standarde të larta profesionale dhe rrjedhimisht mbetet një nga kërkesat me prioritet të Agjencisë. Inspektimet specifike si: përpunimi i të dhënave në sektorin e Policisë, përpunimi i të dhënave personale në sektorin e telekomunikimeve, përpunimi të dhënave personale në sektorin shëndetësor, përpunimi të dhënave personale në sektorin e sigurimeve, përpunimi të dhënave personale në sektorin arsimor, janë të domosdoshme për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të Kosovës.

## 6 Bashkëpunimi ndërinstitucional, regjional dhe ndërkombëtar

### 6.1 Anëtarësimet Ndërkombëtare në 2025

Gjatë vitit 2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi ka konsoliduar praninë e saj në mekanizma ndërkombëtarë relevant, duke siguruar përfaqësim në struktura vendimmarrëse dhe rrjete profesionale që ndikojnë në zhvillimin e politikave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 Agjencia ka siguruar anëtarësime dhe role aktive në organizata dhe struktura ndërkombëtare, me ndikim të drejtpërdrejtë në proceset rregullatore, si në vijim:

- **Konferenca Evropiane Pranverore (Spring Conference)** – Agjencia është pranuar si anëtare me të drejta të plota në këtë forum të rëndësishëm të autoriteteve evropiane për mbrojtjen e të dhënave, në maj 2025. Ky status mundëson pjesëmarrje të barabartë në proceset vendimmarrëse, si dhe kontribut aktiv në zhvillimin e politikave në nivel evropian.
- **Komiteti Drejtues i Spring Conference** – nga prilli 2025, Agjencia është zgjedhur anëtare e këtij organi drejtues me të drejtë vendimmarrëse, duke kontribuar në përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe koordinimin e aktiviteteve të rrjetit.
- **Komitetit Drejtues i Rrjetit Evropian për Transparencë dhe Qasje në Informata (ENTRI)** – Agjencia është bërë anëtare e organit drejtues, duke u bërë pjesë në orientimin strategjik të iniciativave për forcimin e transparencës dhe të drejtës për qasje në dokumente publike.
- **Grupi Ndërkombëtar Punues për Integritetin e Informimit (IIËG)** – Agjencia ka marrë rolin e koordinatorës së këtij grupi, me përgjegjësi në udhëheqjen e aktiviteteve të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në promovimin e praktikave të mira në fushën e integritetit të informacionit.
- **Grupi Punues për Mbikëqyrjen e Inteligjencës Artificiale (AIWG)** – në cilësinë e anëtares së Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA), Agjencia është bërë pjesë e këtij Grupi i cili kontribuon në diskutimet për zhvillimet në fushën e inteligjencës artificiale nga perspektiva e mbrojtjes së të dhënave personale.



- **Programi Ministror i Shoqatës Globale të Operatorëve të Rrjeteve Mobil (GSMA)** – Agjencia është bërë pjesë e dialogot me karakter ndërkombëtar , i cili mbledh autoritet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe autoritete rregullatore të industrisë së telekomunikimit, me fokus në avancimin e standardeve të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave në ekosistemin digjital.
- **Grupi Ndërkombëtar Punues për Fuqizimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (IEWG)** – përfaqësimi i Agjencisë në këtë Grup Punues Ndërkombëtar, përveç që i ka kontribuar bashkëpunimit global me autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale, me theks të veçantë ky Grup trajnon rastet e transfereve ndërkombëtare të të dhënave personale, një fushë me rëndësi dhe interes të veçantë për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale në relacion me shkëmbimin e të dhënave mes shteteve.
- **Grupi i Punës mbi Rolin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Ndhmën Ndërkombëtare për Zhvillim, Ndhmën Humanitare dhe Menaxhimin e Krizave (WG-AID)** – Agjencia është bërë anëtare e rregullt e këtij grupi, i cili adreson sfidat e mbrojtjes së të dhënave në kontekstin e operacioneve ndërkombëtare humanitare dhe përcakton rregullat dhe standardet për mbrojtjen e të dhënave personale në kuptimin e udhëzuesve dhe ndërmarrjen e masave të sigurisë për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave të individëve.

### 6.1.1 Organizimet e punëtorive/konferencave vendore 2025

Në funksion të forcimit të kapaciteteve profesionale dhe përmirësimit të praktikave të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia ka organizuar punëtori dhe aktivitete trajnuese të fokusuara në nevojat konkrete të institucioneve publike, si në vijim:

- Punëtorja për hartimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga organet e zbatimit të ligjit (LED Directive), e cila ka mbështetur procesin e harmonizimit të legjislacionit vendor me standardet evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave.
- Prezantimi i Platformës për identifikimin e rrjedhjes së të dhënave personale, duke krijuar një mekanizëm të strukturuar për raportimin dhe identifikimin e incidenteve të sigurisë së të dhënave.

## 6.2 Angazhimi ndërkombëtar dhe organizimi i aktiviteteve në Kosovë

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka qenë nikoqire dhe bashkëorganizatore e aktiviteteve që kanë sjellë në Kosovë përfaqësues të institucioneve homologe, ekspertë dhe partnerë ndërkombëtarë, duke krijuar hapësira për dialog profesional, shkëmbim përvojash dhe forcim të bashkëpunimit me autoritetet homologe evropiane dhe rajonale.

- **Punëtorja Ndërkombëtare për Lirinë e Informacionit**, e cila mundësoi shkëmbimin e praktikave më të mira evropiane dhe diskutimin mbi zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave për qasje në dokumente publike. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga 14 shtete evropiane: Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Austria, Zvicra,



Portugalia, Spanja, Skocia, Zyra e Avokatit të Popullit Evropian, Kroacia, Hungaria, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

- **Konferenca Rajonale “Iniciativa 2020”**, në kuadër të së cilës Agjencia prezantoi përvojën institucionale të Republikës së Kosovës dhe kontribuoi në formulimin e rekomandimeve për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel rajonal. Në konferencë morën pjesë 15 përfaqësues nga vendet e rajonit, përfshirë Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Slloveninë.
- **Punëtorja Evropiane për Shqyrtimi e rasteve (European Case Handling Workshop-ECHW 2025)**, një aktivitet i nivelit evropian që mbledhi përfaqësues të autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave nga vendet pjesëmarrëse të *Spring Conference*, me fokus në praktikën e trajtimit të rasteve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Në European Case Handling Workshop-ECHW, u mirëpritën në Kosovë rreth 70 përfaqësues të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave nga 23 shtete evropiane, përfshirë: Austria, Belgjika, Çekia, Kroacia, Estonia, Guernsey, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Lituania, Luksemburgu, Maqedonia e Veriut, Malta, Mbretëria e Bashkuar, Holanda, Norvegjia, Polonia, Sllovenia, Suedia, Shqipëria, Turqia, Zvicra dhe Izraeli.

### 6.3 Pjesëmarrja e AIP në grupe punuese jashtë vendit

Gjatë vitit 2025, përfaqësues të Agjencisë kanë marrë pjesë në aktivitete dhe takime ndërkombëtare, duke përfshirë:

- **Përfaqësimi në katër (4) takimet plenare të Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB)**, në të cilën Agjencia ka rolin e anëtarit të rregullt vëzhgues, që mundëson qasje të drejtpërdrejtë në diskutimet dhe interpretimet juridike të rregullativës evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale, në harmoni me zhvillimet e fundit teknologjike. Me theks të veçantë, Bordi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB) ushtron funksion të rëndësishëm përmes opinioneve mbi përdorimin e të dhënave personale në zhvillimin dhe vendosjen e modeleve të inteligjencës artificiale, të cilat në thelb përbëjnë udhëzime që zhvilluesit e këtyre modeleve duhet të ndjekin për të respektuar Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR). Është e rëndësishme të theksohet se pjesëmarrja e AIP në seancat plenare të EDPB kontribuon jo vetëm në cilësinë e përfaqësimit, por edhe në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për hartimin e politikave të reja për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përshtatjen e tyre në Republikën e Kosovës.
- **Përfaqësimi në Konferencën tri ditore Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)**, ku Agjencia ka prezantuar të arriturat dhe sfidat në fushën e qasjes në dokumente publike, me fokus në iniciativat për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve përmes publikimit proaktiv të dokumenteve publike. Prezantimi në konferencë, përkrah përfaqësuesve nga Kanadaja, Australia, Maldivet dhe Azerbajxhani, ka kontribuar në diskutimet me autoritetet ndërkombëtare për qasje në dokumente publike, lidhur me sfidat dhe vështirësitë e institucioneve në raport me transparencën dhe mbrojtjen



e të dhënave personale. Agjencia ka paraqitur shembuj praktikë nga trajtimi i rasteve dhe ankesave, të cilat kontribuan në debatin mbi praktikën më të mira për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Gjatë konferencës, Agjencia ka shprehur interesim për t'u bërë pjesë aktive e Rrjetit Evropian për Transparencë dhe Qasje në Informata (ENTRI), duke kandiduar për Komitetin Drejtues. Në sesionin e dytë të konferencës, me votim unanim, Kosova është pranuar anëtare e Komiteteve Drejtues, përkrah Portugalisë, Spanjës, Francës dhe Skocisë, dhe Gjermanisë si kryesuese të Rrjetit ENTRI.

- **Përfaqësimi në Asamblenë Globale të Privatësisë (GPA)**, Agjencia ka prezantuar dhe kontribuar në diskutimet mbi ndikimin e inteligjencës artificiale në mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Në veçanti, ka paraqitur sfidat që lidhen me mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të fëmijëve, grave dhe grupeve të marginalizuara. Në këtë kontekst, Agjencia ka zhvilluar takime bilaterale me autoritetet e Gjibraltarit, me qëllim iniciimin e nënshkrimit të një marrëveshjeje bilaterale për formalizimin e bashkëpunimit ndërmjet dy autoriteteve. Po ashtu, ka zhvilluar një takim bilateral me Departamentin për Privatësi të GSMA, ku është diskutuar mundësia e organizimit të një konference ndërkombëtare në Kosovë, me qëllim avokimin global për privatësinë digjitale dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale në këtë fushë. Gjithashtu, në kuadër të pjesëmarrjes në Asamblenë Globale, është zhvilluar një takim ndërmjet Autoritetit të Kosovës dhe autoriteteve nga Ishulli i Mani dhe Guernsey, si shtete të vogla që ndajnë sfida të përbashkëta në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me ç' rast diskutimet kanë kontribuar në nxitjen e iniciativave të përbashkëta për realizimin e projekteve në interes të përbashkët.
- **Përfaqësimi në Samitin Global për Privatësi**, pjesëmarrja e Agjencisë ka ofruar mundësinë e shkëmbimit të përvojave në raport me sfidat në fushën e privatësisë karshi inteligjencës artificiale, ku shtetet kanë paraqitur iniciativa për mbrojtjen e të dhënave personale, të orientuara drejt unifikimit të praktikave për të mundësuar zhvillimet teknologjike, duke ruajtur njëkohësisht standardet e mbrojtjes së të dhënave personale. Agjencia ka zhvilluar një takim bilateral me Kryetarin e Komisionit Federal për Tregtinë të SHBA-së (FTC), ku është diskutuar rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, në përputhje me objektivat e Kornizës së Privatësisë së të Dhënave BE-SHBA, e cila synon forcimin e standardeve të mbrojtjes së të dhënave në transferimet ndëratlantike.
- **Përfaqësimi në Konferencën Pranverore të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave**, pas kërkesës dhe komunikimeve paraprake të zhvilluara me autoritetet e Komitetit Drejtues të Konferencës, gjatë pjesëmarrjes në Konferencë, Agjencia është pranuar anëtare me të drejta të plota, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë në forumet vendimmarrëse evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë konferencë, Agjencia ka prezantuar të arriturat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe veprimet e ndërmarra në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publik dhe privat. Ndër të tjera, Agjencia ka prezantuar veprimet e ndërmarra në drejtim të harmonizimit të legjislacionit, përkatësisht nismat për hartimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e sigurisë, në veçanti për institucionet e zbatimit të ligjit, si dhe rolin e saj mbikëqyrës në këtë drejtim.



- **Përfaqësimi në Konferencën Rajonale “ Iniciativa 20i7”**, Agjencia ka prezantuar veprimet e saj, në veçanti mekanizmat dhe iniciativat për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ndërveprimin ndërmjet mbrojtjes së të dhënave dhe ndikimit të inteligjencës artificiale. Konferenca ka trajtuar çështje që lidhen me përdorimin e kamerave biometrike në hapësira publike dhe sfidat për mbrojtjen e të dhënave në përbashkësi me teknologjitë e reja, në kushtet e kapaciteteve të kufizuara profesionale dhe financiare. Si rezultat i kësaj konference, autoritetet pjesëmarrëse kanë miratuar një deklaratë të përbashkët për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit, në funksion të zbatimit të strategjive për tejkalimin e sfidave në rajon.
- **Përfaqësimi në Simpoziun e Privatësisë 2025**: “Përtej BE-së – Fuqizimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar ndërmjet Autoriteteve Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Agjencia, në nivel përfaqësimi të barabartë me vendet pjesëmarrëse, ka theksuar rëndësinë e ndërtimit të partneriteteve të qëndrueshme për avancimin e mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë kuadër, Agjencia ka paraqitur arritjet e Kosovës si një shtet në zhvillim dhe që në objektivat e saj zhvillimore synon përputhjen e plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Në këtë kontekst, është veçuar bashkëpunimi i vazhdueshëm i Agjencisë për Informim dhe Privatësi me autoritetet homologe nga Kroacia, Shqipëria, Austria, Sllovenia, Maqedonia e Veriut, Letonia dhe Estonia, i cili ka kontribuar në forcimin e kuadrit ligjor, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe nxitjen e iniciativave të përbashkëta për mbrojtjen e të dhënave personale.
- **Përfaqësimi në Mobile World Congress (MWC) 2025** – Në kuadër të Kongresit, përkatësisht, Programit Ministror, Agjencia ka marrë pjesë në diskutimet e përbashkëta me autoritetet pjesëmarrëse për mbrojtjen e të dhënave me temën “Sigurimi i Privatësisë së të Dhënave për të Ardhmen”. Gjatë diskutimeve, janë adresuar zhvillimet dhe sfidat e ndikimit të inteligjencës artificiale dhe ndërlidhjen globale të të dhënave personale, duke reflektuar përvojën dhe qasjen e Kosovës në forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me standardet evropiane. Është theksuar nevoja për krijimin e mekanizmave rregullatorë që mbrojnë të drejtat e qytetarëve, duke mundësuar njëkohësisht zhvillimet teknologjike. Pjesëmarrja e Agjencisë ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në promovimin e qasjes proaktive për mbrojtjen e të dhënave në kuptimin e shkëmbimit të përvojave më të mira.
- **Përfaqësimi në Konferencën ndërkombëtare mbi rolin e Konventës së Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale në mbrojtjen e të dhënave personale**, ka mundësuar Agjencisë zhvillimin e bashkëbisedimeve bilaterale me përfaqësues të institucioneve kryesore evropiane, përfshirë Komitetin e Konventës 108, Komitetin për Inteligjencë Artificiale të Këshillit të Evropës (CAI), Mbikëqyrësin Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPS), si dhe autoritetet evropiane të mbrojtjes së të dhënave. Pjesëmarrja në Konferencë ka kontribuar në forcimin e dialogut ndër-institucional dhe në mbështetjen e procesit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me standardet e Bashkimit Evropian, Konventës 108+ dhe kornizave të reja të Këshillit të Evropës për Inteligjencë Artificiale. Gjithashtu, janë vendosur kontakte institucionale me Ministrinë e Drejtësisë së Gjermanisë, me fokus në shkëmbimin e përvojave lidhur me avancimin e praktikave për trajtimin e rasteve gjyqësore përmes mekanizmave me bazë të inteligjencës artificiale me qëllim të



ngritjes së kapaciteteve institucionale për rritjen e efikasitetit të zgjidhjes së rasteve gjyqësore.

- **Përfaqësimi në takimet e Grupit të Berlinit për mbrojtjen e të dhënave në teknologji,** Pjesëmarrja e Agjencisë ka mundësuar diskutime mbi zhvillimet që lidhen me teknologjitë informative në raport me mbrojtjen e të dhënave personale dhe inteligjencën artificiale. Në këtë kuadër, takimet e Grupit të Berlinit kanë trajtuar, me theks të veçantë, çështje që lidhen me përdorimin e teknologjive për mbledhjen e të dhënave biometrike, sfidat që ndërlihen me përpunimin masiv të të dhënave personale, si dhe transparencën e sistemeve digjitale në zbatimin e masave të sigurisë gjatë procesit të përdorimit të këtyre sistemeve, përfshirë edhe aspektet e gjurmimit.

**Përfaqësimi në takimet e autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEDPA),** rezultoi në forcimin e bashkëpunimit ndërinstucional dhe krijimin e bashkëpunimeve të qëndrueshme për koordinim në trajtimin e çështjeve të përbashkët. Me ftesë të Qendrës së Kapaciteteve Kibernetike të Ballkanit Perëndimor (WB3C) dhe Forumit Ekonomik Botëror (WEF), Agjencia ka marr pjesë në Seminarin dy ditor për Ndërtimit të Kapaciteteve Kibernetike në Ballkani Perëndimor në Podgoricë. Në Seminarin e Ndërtimit të Kapaciteteve Kibernetike në Ballkani Perëndimor morën pjesë përfaqësues nga institucionet publike, sistemi i drejtësisë, sektori privat dhe akademik, si dhe ekspertë ndërkombëtarë të sigurisë kibernetike ndërsa u prezantuan përvojat e mira dhe sfidat rajonale ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike.

**Përfaqësimi në Edicioni i tretë i Javës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale** - Gjatë këtij edicioni, Agjencia ka prezantuar aktivitetet e institucionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ka prezantuar të arriturat dhe sfidat e Agjencisë në raport me inteligjencën artificiale dhe bashkëpunimin ndër instucional në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Edicioni i tretë i Javës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale u organizua nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), në bashkëpunim me Programin SIGMA, “Fondin Rajonal të Partneritetit Lindor për Reformën e Administratës Publike” të zbatuar nga GIZ, Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), si dhe në partneritet me Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës, EDPB dhe EDPS.

**Përfaqësimi në Konferencën Rajonale me temën: “Mbrojtja e Integritetit Zgjedhor”,** Gjatë pjesëmarrjes në këtë konferencë, Agjencia ka prezantuar angazhimet dhe rolin e AIP-së në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstucional për garantimin e integritetit zgjedhor në Kosovë. Në veçanti Agjencia ka prezantuar bashkëpunimin me organizatat jo-qeveritare, mediat dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si faktorë kryesor për garantimin e transparencës për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve gjatë procesit zgjedhor.

Konferenca dy ditore u organizua nga Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (OSCE-ODIHR).

**Përfaqësimi në Grupin Punues "Mbrojtja e Lirisë së Shprehjes dhe e Medias në Ballkanin Perëndimor (PRO-FREX)",** Këshilli i Evropës – Agjencia ka marrë pjesë në takimin e Grupit Punues me karakter ndërkombëtar duke kontribuar me propozimet për përgatitjen e planit të veprimit të Grupit Punues dhe Aktivitetet.



## 6.4 Rekomandimet

Orientimet strategjike të Agjencisë për vitin 2026 do të jenë të koncentruara në sigurimin e zbatimit dhe respektimit të politikave të privatësisë në institucionet e sektorit publik dhe privat forcimin e partneritetet me institucionet vendore dhe institucionet homologe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Në mënyrë specifike, prioritet i Agjencisë për vitin 2026, mbetet rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të subjekteve publike, privatë dhe qytetarëve në tërësi, për mbrojtjen e të dhënave personale me fokus ndërgjegjësimin e qytetarëve në përdorimin e internetit dhe platformave elektronike të komunikimit.

Forcimi i kapaciteteve profesionale të zyrtarëve për Inspektim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, forcimi i partneritetet me institucionet ndërkombëtare dhe institucioneve homologe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, Zhvillimin e programit të transparencës dhe Organizimin e fushatave informuese për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike. Rritja e numrit të aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe komunikimit me institucionet publike dhe private në Kosovë, mbetet objektiv i rëndësishëm i Agjencisë për vitin 2026 që synon rritjen e bashkëpunimit të Agjencisë me institucionet si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe private që përpunojnë të dhëna personale.

Forcimi i kapaciteteve institucionale në kuadër të zbatimit të ligjit dhe avancimit të kornizës ligjore të Agjencisë gjithashtu është një ndër fushat me prioritet të Agjencisë për vitin 2026, është - Përgatitja e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ne institucionet e zbatimit të ligjit si dhe nxjerrjen e Udhëzuesve praktik për fusha të caktuara, dhe specifike që do të shërbejnë si mjet informimi për subjekte dhe qytetarët.

Më fokus të veçantë në vitin 2026, Agjencia do të punoj në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në zhvillimin e mëtejme të bashkëpunimit ndër institucional në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është një hap strategjik për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e standardeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike.

Përkritazi me zhvillimet e shpejta në fushën e teknologjisë, përfshirë zhvillimet në Inteligjencën Artificiale (IA), Agjencia synon të adresojë rreziqet dhe sfidat e reja për të siguruar masa parandaluese nëpërmjet komunikimit dhe ndërgjegjësimit të kontrolluesve publik, privat dhe qytetarëve në tërësi dhe Agjencia po ashtu do të vazhdojë angazhimin e orientuar në ndikimin e Inteligjencës Artificiale në privatësi, duke analizuar dhe vlerësuar rreziqet e mundshme të përpunimit të të dhënave në mënyrë të automatizuar dhe vendimmarrjes së bazuar në algoritme. Sigurimi i rritjes së kapaciteteve profesionale dhe të ekspertizës për zyrtarët e Agjencisë në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike, marrë parasysh numrin në rritje të ankesave dhe kompleksitetin e rasteve të trajtuara, është me prioritet për Agjencinë dhe do të kontribuonte në rritjen e profesionalizmit dhe cilësisë së vendimmarrjes. Funkcionalizimi i procesit të digjitalizimit, gjegjësisht ofrimi i shërbimeve për qytetarët në përgjigje të rritjes së transparencës në ofrimin e shërbimeve dhe zvogëlimin të barrës administrative të Agjencisë, është nevojë e domosdoshme për të rritur efikasitetin e shërbimeve operacionale të Agjencisë, më saktësisht trajtimin e ankesave për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në të njëjtën kohë, rekomandohet rritja e aktiviteteve vetëdijësuese dhe trajnimeve për institucionet publike, veçanërisht për kategoritë me numër më të lartë ankesash (dikasteret qeveritare dhe komunat), me qëllim të përmirësimit të zbatimit pro aktiv të Ligjit për Qasje në



Dokumente Publike dhe reduktimit të rasteve që përfundojnë me masa ndëshkuese sikurse forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të vendimeve do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia mbeten prioriteti kryesor i Agjencisë dhe orientimet strategjike të Agjencisë do të jenë të fokusuara në krijimin e një mjedisi të besueshëm dhe të sigurt të përdorimit të teknologjisë informatave nga ana e qytetarëve.

## 7 Raporti Financiar

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) ka buxhetin e saj, i cili administrohet në mënyrë të pavarur në pajtim me ligjin. Buxheti final i Agjencisë përcaktohet nga Kuvendi i Kosovës, gjegjësisht kërkesa finale shqyrtohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, duke respektuar planifikimin buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Në pasqyrat financiare pasqyrohet buxheti fillestar prej 495,563.00 euro duke u bazuar në ndarjet buxhetore sipas Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës të Kosovës për Vitin 2025, ku ky buxhet përfundimtar ka pësuar ndryshime sipas Vendimit 03/261 në mbledhjen e Qeverisë me datë 05.06.2025, Agjencisë ju janë alokuar mjete shtesë në vlerë prej 11,919.60€ në paga dhe shtesa për rritjen prej 0.5 njësi (zero pikë pesë) të koeficientit, shtesë që është aplikuar nga muaji korrik 2025. Me këtë rast buxheti total i Agjencisë është shtuar në 507,482.60€

Pas shkresës nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve duke u bazuar në dokumentin “Përmbyllja e vitit fiskal për vitin 2025”, shkresa me datë 03/10/2025 nr. Ref. 3066-2025, nga buxheti i përgjithshëm bazuar në planifikimet e nevojshme në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbime (130) bazuar në planifikimin për shpenzime deri në fund vit dhe ndarjet buxhetore ne nuk kemi mund të ndajmë mjete për kursime. Kjo duke u bazuar edhe në kërkesën për shtesë buxhetore nga Agjencia për MFPT të datës 06.10.2025 me numër protokolli 1202/25.

Gjithashtu nga kategoria Shpenzime komunale (132) nuk kemi ndarë për kursime mjete për shkak të planifikimit të saktë të mjeteve të nevojshme për këtë vit.

Ne kemi bërë edhe rregullimin e brendshëm në kategoritë e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime”.

Deri sa në fund vit me vendim Nr.01/281 të datës 24.12.2025 me kërkesë të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen Nr. 281/2025 të mbajtur me datë 24 dhjetor 2025 ka bërë prerje buxhetore lidhur me buxhetin e pa shpenzuar në kategorinë “Paga dhe Shtesa” kurse sipas Aneksit A (kursime), Agjencisë i janë larguar si kursime 5,393.78€ dhe buxheti final në SIMFK ishte 502,088.82€ (Paga dhe Shtesa 355,638.82€ Mallra dhe Shërbime 144,000.00€ dhe Shpenzime Komunale 2.450,00€). Buxheti final i alokuar në SIMFK deri me 31 dhjetor 2024 është po ashtu 502,088.82€ (Paga dhe Shtesa 355,638.82€ Mallra dhe Shërbime 144,000.00€ dhe Shpenzime Komunale 2.450,00€).

Të hyrat jo-tatimore nga gjobat janë 38,400.00€

Si detyrime kontigjente janë ato lëndë të cilat ende janë në procese gjyqësore në Gjykata, të cilat varësisht prej vendimmarrjes së Gjykatave, potencialisht mund të kenë ndikim në aspektin buxhetor në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe shuma totale e tyre është 73,500.00€



Gjatë vitit 2025 nuk kemi pas shpenzime për blerje të pasurive jo-kapitale në vlerën nën 1000 euro. Vlera në libër e pasurisë deri me datë 31.12.2025 është 21,475.51€ sipas vlerësimeve nga komisioni për inventarizim dhe komisioni për vlerësim të pasurisë.

***Totali i shpenzimeve nga 01 Janar 2025 deri me datën e përpilimit të raportit 31 dhjetor 2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi ka shpenzuar nga buxheti i përgjithshëm €495,475.56 nga këto kategori: paga dhe mëditje €355,638.82, mallra dhe shërbime €137,755.35 dhe shërbime komunale €2,081.39.***

## **2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:**

### **a) Të hyrat:**

Marrë parasysh mandatin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi në shqiptimin e gjobave nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe qasjes në dokumente publike, në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, AIP ka shqiptuar gjoba në shumën totale prej 198,000.00€

Në kuadër të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, gjatë vitit 2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) ka pranuar gjithsej 927 ankesa. Nga ky numër, 781 ankesa janë trajtuar dhe mbyllur, ndërsa 146 ankesa vazhdojnë të jenë në proces shqyrtimi, të gjitha brenda afateve të përcaktuara ligjore. Në aspektin e zbatimit ekzekutiv të vendimeve, në kuadër të fushëveprimtarisë së Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave, përmes Departamentit për Qasje në Dokumente Publike, gjatë periudhës raportuese janë shqiptuar gjithsej 18 gjoba administrative, në vlerë të përgjithshme prej 64,000.00 euro, për moszbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Qasje në Dokumente Publike, katër gjoba të shqiptuara në vlerë prej 12,000.00€ janë paguar dhe shuma e të hyrave nga ato është 7,500.00.

Deri sa në vitin 2024 AIP ka pranuar 693 ankesa, 606 prej të cilave janë mbyllur dhe 87 të tjera janë në proces të shqyrtimit, brenda afateve të përcaktuara ligjore. Numri i gjobave të shqiptuara nga zbatimi i ligjit për qasje është 6 (gjashtë), në shumën totale prej 21,000.00€ Nga viti 2023 janë paguar €32,748.12€ përmes proceduarve përmabrimore deri sa një gjobë nuk është paguar ende vlera 3,000.00€ dhe një është akoma në procedurë përmbarimore vlera 3,000.00€ Nga viti 2022 një gjobë ende nuk është paguar. Të hyrat nga gjobat e shqiptuara gjat vitit 2024 lidhur me zbatimin e ligjit për qasje janë 6,200.54€ duke e përfshirë edhe një përmes procedurës përmbarimore që ishte e vitit 2024 deri sa të hyrat në total nga qasja duke e përfshirë edhe gjobat që ishin në procedurë përmbarimore të vitit 2023 e që janë paguar në 2024 janë në total €€ 38,948.66 .

Të hyrat e realizuara nga taksa e biometrisë janë 100.00€ deri sa të hyrat nga taksa e transferit ndërkombëtarë 300.00€

Në kuadër të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Numri i inspektimeve sipas detyrës zyrtare për periudhën Janar – Dhjetor 2025, është dyqind e njëzet e gjashtë (226) inspektime sipas detyrës zyrtare

Sektorët në të cilët janë realizuar inspektimet sipas detyrës zyrtare:



- Shtatëmbëdhjetë (17) janë për kontrollues publik
- Dyqindë e nëntë (209) për kontrollues privat.

Fushat në të cilat janë realizuar inspektimet;

- Dy (2) inspektime lidhur me shpërndarje të dhënave personale.
- Gjashtë (6) inspektime lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të dhënave personale
- Tetë (8) inspektime lidhur me publikimin e të dhënave personale.
- Dy (2) përpunimi i karakteristikave biometrike
- Njëqind e gjashtëdhjetë e një (161) inspektime lidhur me përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë.
- Katërdhjetë e një (41) në sektorin shëndetësor, laboratore, lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale
- Tre (3) inspektime në sektorin e sigurimeve shëndetësore.
- Tre (3) inspektim lidhur me rrjedhjen e të dhënave personale.

Numri i vendimeve për këtë periudhë është shtatëmbëdhjetë (199) vendime sipas detyrës zyrtare.

1. Gjobë është shqiptuar në vlerë prej 20,000 euro për publikimin e të dhënave personale të nga Universiteti “Isa Boletini”.
2. Gjobë lidhur me vëzhgimin me kamerë për kontrolluesin “Proex-Interex” në vlerë prej 8.000 euro lidhur me vëzhgimin me kamerë.
3. Gjobë e shqiptuar në vlerë 25.000 euro, për publikim e të dhënave personale ndaj kontrolluesit “KESCo” Prishtinë.

#### Ankesat

Nga 01.01.2025 deri 24.12.2025, janë pranuar gjithsej njëqind e pesëdhjetë e tetë (158) ankesa prej të cilave njëqind e tridhjetë e nëntë (139) janë përfunduar me vendim dhe në shqyrtim kanë mbetur nëntëmbëdhjetë (19) ankesa.

Natyra e ankesave janë:

- Vëzhgim me kamerë pesëdhjetë e dy (52) ankesa,
- Marketing i drejtpërdrejtë njëzet e shtatë (27) ankesa
- Keqpërdorim i të dhënave personale dymbëdhjetë (12) ankesa
- Kërkesë për qasje në të dhëna personale tetë (8) ankesë,
- Shpërndarje e të dhënave personale nëntë (9) ankesa,
- Publikim i të dhënave personale tridhjetë e tre (33) ankesa.
- Kërkesë për fshirjen e të dhënave dy (2) ankesa
- Lidhur me masat e sigurisë një (1) ankesë



- Përpunim i të dhënave pa bazë ligjore katërbëdhjetë (14) ankesa

Gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë njëqind e katerdhjetë e një (141) vendime në bazë të ankesave prej të cilave njëqind e njëzet e nëntë (129) vendime janë nxjerrë për ankesat e vitit 2025 ndërsa dymbëdhjetë (12) vendime janë nxjerrë për ankesat e pranuar në vitin 2024.

Gjatë shqyrtimit të ankesave janë shqiptuar shtatë gjoba për kontrolluesin Asistenca Rrugore në vlerë prej 4.000 euro, Kompania e Ujësjesit Rajonal Prishtina në vlerë 25.000 euro, Natyra Terapi prej 4.000 euro, Autoriteti i Konkurrencës në vlerë 20.000 euro, Portali Sinjali në vlerë 20.000 euro, kompania Hebs Sh.P.K në vlerë 4.000 dhe kompania RoadSide Assistance Kenguri Sh.P.K në vlerë 4.000 euro. Kontrolluesit kanë zbatuar vendimin dhe gjoba janë paguar.

Numri i inspektimeve sipas detyrës zyrtare në total është 226 inspektime.

Numri i inspektimeve sipas ankesës është 141 inspektime.

Në total inspektime janë gjithshjejtë 367 inspektime.

Numri i vendimeve në total për vitin 2025 është 340 vendime.

Deri sa numri i ankesave të pranuar në AIP gjatë vitit 2024 është 134, nga të cilat, me Vendime përfundimtare të mbyllura janë 112 dhe në faze të shqyrtimit janë 22. Numri total i inspektimeve sipas ankesës dhe detyrës zyrtare është 324 ku prej tyre inspektime sipas ankesave janë 116 deri sa inspektime sipas detyrës zyrtare janë 208.

Sektorët në të cilët janë realizuar inspektimet sipas ankesave:

- dymbëdhjetë (36) te kontrolluesit publik
- njëmbëdhjetë (80) te kontrolluesit privat

Agjencia ka realizuar 208 inspektime sipas detyrës zyrtare, prej të cilave 186 inspektime janë realizuar të kontrolluesit privat ndërsa 22 inspektime janë realizuar të kontrolluesit publik, nga të cilat janë nxjerr 199 vendime. Numri total i vendimeve - numri i vendimeve përfundimtare të nxjerra deri më 31.12.2024 është 311, ku në këtë numër janë edhe vendimet e nxjerrur në vitin 2024 për rastet e vitit 2023, nga të cilat janë shqiptuar pesë (5) gjoba kundërvajtëse me shumë totale shtatëdhjetëmijë (72,000.00) euro. Dy (2) nga këto gjoba janë shqiptuar ndaj kontrolluesve publik dhe tre (3) gjoba ndaj kontrolluesve privat. Të hyrat nga gjobat e shqiptuara nga zbatimi i ligjit për MDHP për vitin 2024 janë 40,000.00€, nga të cilat janë shqiptuar 5 (katër) gjoba kundërvajtëse me shumë totale 72,000.00 euro. Të hyrat nga gjobat e shqiptuara nga zbatimi i ligjit për MDHP për vitin 2024 janë 40,000.00€, deri sa një është paguar në fillim të vitit 2025 në vlerë prej 4,000.00€një e shiptuar me datë 26.12.2024 dhe një tjetër në vlerë prej 4,000.00€nuk është paguar ende.

Numri i përgjithshëm i inspektimeve të realizuara gjatë këtij viti është 208 inspektime sipas detyrës zyrtare, prej të cilave 186 inspektime janë realizuar të kontrolluesit privat ndërsa 22 inspektime janë realizuar të kontrolluesit publik, nga të cilat janë nxjerr 199 vendime.

Sektorët në të cilët janë realizuar inspektimet e rregullta:

- Kontrollues publik (22)



- **Kontrollues privat (186).**

Në vijim, në formë tabelore, janë të paraqitura përmbledhja e të hyrave dhe kategoritë e veçantë të shpenzimeve të Agjencisë për Informim dhe Privatësi:

Përshkrimi	Shënime	2025	2024	2023	% e totalit 2025	% e ndryshimit nga 2024
		€ '000	€ '000	€ '000		
Të hyrat nga taksat - Bioemtri		0	0		%	%
Të hyrat nga taksat - Transferi		0	0		%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat MDHP		31	40	16	%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat QDP		8	39	6	%	%
Të hyrat nga licencat 1					%	%
Të hyrat nga licencat 2					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria					%	%
Pranimet tjera					%	%
<b>Gjithsej</b>		<b>38</b>	<b>79</b>	<b>22</b>	<b>0%</b>	<b>%</b>

### b) Pagat dhe mëditjet:

Pagat dhe mëditjet – Buxheti fillestar për vitin 2025 për paga dhe mëditje ka qenë 349,113.00€ me ndryshim sipas Vendimit 03/261 në mbledhjen e Qeverisë me datë 05.06.2025, Agjencisë ju janë alokuar mjete shtesë në vlerë prej 11,919.60€ Me këtë rast buxheti total i Agjencisë është shtuar në 507,482.60€ ku më pas në fund vit me Vendim të Qeverisë dhe kërkesë të Ministrisë të MFPT, Agjencisë i janë larguar si kursime 5,393.78€ dhe buxheti final në SIMFK për paga dhe shtesa ishte 355,638.82€ Me 31 dhjetor 2025 buxheti final i alokuar ishte 502,088.82€ (Paga dhe Shtesa 355,638.82€, Mallra dhe Shërbime 144,000.00€ dhe Shpenzime Komunale 2.450,00€).

Përshkrimi	2025									2024 -1 € '000	2023 -2 € '000	
	Gjithsej								Buxheti			Ndryshimi
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000			Buxheti - Pagesat € '000
Pagat neto përmes listave të pagave	285			285							239	186
Funkcionet shtesë	2			2							1	
Puna jasht orarit të punës	3			3							3	
Shtesa për vëllimin e punës	1			1							0	
Shtesat tranzitore											0	
Punëtoret me kontrate (jo në listën e pagës)												
Përvoja e Punës	10			10							8	
Tatimi ndalor në të ardhurat personale	21			21							18	14
Kontributi pensional - punëtori	17			17							14	11
Kontributi pensional - punëdhënës	17			17							14	11
Pagesa për vendime gjyqësore	-			-								
<b>Paga dhe shtesa</b>	<b>356</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>356</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>356</b>	<b>0</b>	<b>298</b>	<b>221</b>	

Agjencia për Informim dhe Privatësi, me buxhetin e aprovuar për vitin 2025, ka pasur gjithsej 34 pozita pune, prej të cilave 1 pozitë pune vakante.

Në fillim të vitit 2025 NJMBNJ ka hartuar planin e personelit duke paraparë të gjitha pozitat vakante duke përfshirë edhe ato pozita për të cilët rekrutimi kishte filluar në vitin 2024 ndërsa kanë përfunduar në 2025.

Gjatë vitit 2024 sipas nevojave të paraqitura janë rekrutuar 2 pozita pune “Ekspert për transparencë” të cilat pozita nuk kanë qenë të parapara në planifikim të personelit, planifikim



të rekrutimeve dhe as në strukturën organizative të AIP e që njëres pozitivisht është zgjatur kontratat deri në 2026. Kjo me qëllim të realizimit të projektit për transparencë janë rekrutuar dy ekspert sipas kontratës me kohë të caktuar (6 muaj deri në 2 vjet) dhe të njejtat pozita janë vendosur në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve.

**c) Mallra dhe Shërbime:**

Buxheti fillestar për vitin 2025 për mallra dhe shërbime ka qenë 144,000.00 € ku janë shpenzuar 137,755.35€ MFPT në fund vit nuk kanë bërë prerje buxhetore lidhur me buxhetin e pa zotuar dhe deri sa buxheti final në SIMFK në mallra dhe shërbime ishte i pa ndryshuar 144,000.00€ të alokuara ishin 144,000.00€ deri sa shpenzimi në këtë kategori ishte 137,755.35€ zotim/Obligimiet ishin 5,261.90€ deri sa mbetja ishte 982.75€ Gjatë vitit 2025 AIP ka bërë rregullimet e brendshme në nënkategorit. Mjetet të cilat nuk janë shpenzuar në kategorinë mallra dhe shërbime është pasi që disa kontrata për shërbime dhe furnizim kanë qenë me vlerë më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës si dhe shumë aktivitete si p.sh. trajnimet e punonjësve të ri nuk janë realizuar pasi që rekrutimi ka përfunduar në pjesën e dytë të vitit 2025.

Përshkrimi	2025								Buxheti Final € '000	Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	2024 € '000
	Gjithsej										
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000			
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-				0					0	
Medijet për udhëtime zyrtare brenda vendit	0				0					0	
Akomodimi u dhëtime zyrtare brenda vendit	1				1					1	
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare brenda vendit	-				0					0	
